



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

(Auditim Përputhshmërie, Tematik)

“UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU”, DURRËS

Tiranë, Janar 2021



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

Përmbajtja

Nr.	Emërtimi	Faqe
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3-6
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3-3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3-5
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	5-6
II	HYRJA	7-9
1.	Titulli	7-7
2.	Marrësi	7-7
3.	Qëllimi dhe Objektivat	7-7
4.	Identifikimi i çështjes	7-7
5.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	7-7
6.	Përgjegjësitë e audituesve	7-8
7.	Kriteret e vlerësimit	8-8
8.	Standardet e auditimit	8-8
9.	Metodat e auditimit	9-9
10.	Dokumentimi i auditimit	9-9
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	9-50
	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	9-10
	Përshkrim i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	
	<i>Drejtimi 1: “Vlerësimi i zbatimit të kontratave për ndërtimin e kampusit universitar”</i>	11-18
	<i>Drejtimi 2: “Mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit të Institucionit”</i>	19-50
	<i>Drejtimi 3: “Mbi krijimin dhe shlyerjen e detyrimeve”</i>	50-55
IV	GJETJET DHE REKOMANDIMET	55-56
V	ANEKSE	-



KONTROLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës”, më poshtë i emërtuar UAMD, për periudhën nga data 01.01.2013 deri 20.09.2020 me objekt “Auditim tematik përputhshmërie”. Auditimi u orientua në tre drejtime kryesore të përcaktuara në programin e auditimit me fokus në detyrimet e prapambetura të institucionit sa i përket investimeve të kryera. Në këtë auditim u angazhuan 3 (tre) auditues të Kontrollit të Lartë të Shtetit. Konkluzionet përkatëse paraqiten në mënyrë më të hollësishme në pjesën e III dhe IV, të këtij Raporti Përfundimtar. Sipas treguesve të paraqitur nga institucioni për periudhën nga viti 2013 deri më shtator 2020 rezultoi se, megjithëse numri i studentëve ka ruajtur të njëjtin trend, të ardhurat evidentohen me një trend të theksuar zbritës në periudhat prej vitit 2019 dhe në vijim. Ndikim në uljen e të ardhurave të veta të krijuara nga institucioni janë vendimet e Këshillit të Ministrave për arsimin e lartë të publikuara në muajin dhjetor 2018, për bursat financiare të studentëve dhe atyre për përjashtim, apo reduktim të tarifavës vjetore të cilat së bashku kanë impaktuar rëndësishëm në të ardhurat e institucionit. Po kështu ndikim në të ardhurat pas vitit 2018 ka patur edhe heqja e pagesave shtesë për studentët për tërheqjen e vërtetimeve apo dokumentacioneve të tjera nga Sekretaritet Mësimor, sipas vendimit nr. 163 datë 14.12.2018 të Senatit Akademik në UAMD. Sa i përket investimeve të bëra përgjatë kësaj periudhe evidentojmë se, vlerat e investimeve të kryera paraqiten në vlera të konsiderueshme për periudhën 2017 dhe 2018 ndërsa për periudhën 2019 dhe 9-mujorin 2020 ato kanë pësuar ulje të theksuar çka përkon dhe me rënien në të ardhura. Vlerat e palikuiduara në fund të periudhave ushtrimore i referohen në gati plotësisht investimeve të kryera në UAMD dhe në një masë shumë të vogël i përkasin mallrave apo shërbimeve të prokuruar. Institucioni ende nuk disponon një kuadër të plotë rregullativ për mirëfunksionimin financiar dhe atë organizativ. Në përfundim të procedurës audituese, akt-konstatimeve, Projekt Raportit të mbajtur, observacioneve të paraqitura, u rekomanduan masat përkatëse për përmirësimin e situatës.

I.2 Një përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi paraqitet sa më poshtë:

N R.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR	RËNDË SIA	REKOMANDIMI
1.	- Nga auditimi rezultoi se, Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, në zbatim të nenit 132 të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë” ka hartuar vetëm disa prej akteve rregullativë të kërkuar nga ligji. Konkretisht është hartuar statuti i ri i cili është miratuar nga ministri përgjegjës për arsimin me Urdhrin nr. 385 datë 09.07.2018, i ndryshuar, si dhe “Rregullorja e Brendshme” e institucionit e miratuar me	Drejtimi nr. 2 <i>“Mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit të Institucionit”</i>	E mesme	- UAMD të ndërmarrë veprimet e nevojshme administrative, për hartimin dhe miratimin e “Rregullores për Funksionimin e Bordit të Administrimit”, “Rregullores Financiare” si dhe akteve të tjerë të nevojshëm për plotësimin e kuadrit rregullator të institucionit dhe garantimin e mirëfunksionimit administrativ dhe



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

	vendimin nr. 154 datë 26.11.2018 prej Senatit Akademik. Veç akteve të sipërcituar, UAMD nuk ka hartuar dhe miratuar ende “Rregulloren mbi funksionimin e Bordit të Administrimit” i cili është organi më i lartë drejtues administrativ në IAL si dhe “Rregulloren Financiare” e cila miratohet prej Bordit të Administrimit. Referuar kërkesave të ligjit kjo bazë rregullative duhet të hartohet brenda vitit të parë akademik nga hyrja në fuqi e ligjit. Mospërbushja e këtij detyrimi nga ana e institucionit bie në kundërshtim me neni 33 pika 3, neni 49 pika 1/a,c,e, dhe neni 132 të ligjit nr. 80/2015 por dhe akteve ligjore e nënligjor mbi hartimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit. Ndikimi evidentohet si në aspektin e mirëfunksionimit organizativ por dhe atij financiar, pasi këto akte rregullative përmbajnë proceset dhe hapat që duhet të ndërmerren nga njësitë e veçanta në IAL, për hartimin e buxhetit vjetor dhe atij afatmesëm si dhe rolin mbikëqyrës të Bordit të Administrimit në zbatimin e tij.	<i>Trajtuar më hollësisht në faqet nr 19-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.</i>		financiar.
2.	Nga auditimi rezultoi se, Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, në fund të muajit shtator 2020 paraqitet me një situatë detyrimesh të palikujduara në shumën rreth 73.4 milion nga të cilat 69.7 milion lekë përfaqësohen nga “Detyrime për investime” ndërsa pjesa tjetër i përket detyrimeve për mallra dhe shërbime. Nga vlera e papaguar për investime, rreth 54.8 milion lekë ose rreth 79% janë detyrime të mbartuara nga periudha të mëparshme, ndërsa 14.9 milion lekë ose rreth 21% e tyre i përkasin detyrimeve të krijuara në 9 muajin e vitit 2020. Investimet e palikuiduara u përjashtojnë punimeve ndërtimore dhe pajisje të nevojshme për godinën e re universitare. Në fund të vitit 2018 si rrjedhojë e aplikimit të reduktimit të tarifave studentore si dhe heqjes së pagesave shtesë për studentët për tërheqjen e dokumentacioneve të tjera nga Sekretariteti Mësimor, të ardhurat e institucionit janë tkurrur ndjeshëm. Këto ndryshime kanë përgjysmuar të ardhurat, ndërkohë që institucioni trashëgonte vlera të konsiderueshme detyrimesh të prapambetura nga periudhat e mëparshme. Megjithatë planifikimet buxhetore në periudhat vijuese kanë qenë konservatore, ende sot një pjesë e këtyre detyrimeve të trashëguara qëndrojnë në regjistrat e institucionit si detyrime për tu paguar. Pavarësisht nevojës për investime dhe ambiente të reja, në funksion të mësimdhënies dhe cilësisë së	Drejtimi nr. 3 <i>“Mbi krijimin dhe shlyerjen e detyrimeve”</i> <i>Trajtuar më hollësisht në faqet nr 50-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.</i>	E mesme	- UAMD të kryej një planifikim më të kujdeshëm të investimeve të reja duke i dhënë prioritet fillimisht likuidimit të detyrimeve të prapambetura dhe respektuar rigorozisht radhën FIFO për pagesë, referuar momentit kur detyrimi ka lindur.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

saj, nga ana e institucionit duhej të ishte ndjekur një qasje më e kujdesshme mbi planifikimin dhe kryerjen e tyre në kohë, me qëllim ruajtjen e balancave financiare dhe mosakumulimin e vazhdueshëm të tyre. Moslikuidimi i detyrimeve sipas afateve të përcaktuara në kontratë e ekspozon buxhetin e institucionit drejt risqeve për pagesa kamatëvonesash shtesë, referuar përcaktimeve të nenit 5 të ligjit nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”			
---	--	--	--

I.3. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit

-Konkluzion i Përgjithshëm

-Nga auditimi rezultoi se, Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, regjistron vlera detyrimesh të prapambetura të cilat lidhen kryesisht me punime ndërtimi për godinat universitare si dhe pajisjeve të blera në funksion të procesit mësimor. Nga ana e institucionit nuk është treguar kujdesi i duhur për të mos akumulimin në vijimësi të detyrimeve dhe për të mos riskuar pagesa kamatëvonesash nga mospagesat në kohë të detyrimit. Evidentohet mungesë e akteve rregullativë mbi hartimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen financiare të cilat duhet të ishin miratuar sipas përcaktimeve në ligjin e ri për arsimin e lartë dhe që kanë ndikime të rëndësishme në efikasitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm të Institucionit.

Opinion i Auditimit

-Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë administrative të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat ky institucion realizon misionin e tij, (kriteret e auditimit të përputhshmërisë) me fokus të veçantë likuidimin e detyrimeve të prapambetura. Në përfundim të procedurave audituese janë konstatuar disa të meta dhe mangësi që lidhen kryesisht, me mungesën e kuadrit të plotë rregullator për miradministrimin financiar, mbartjen nga institucioni në vijimësi të detyrimeve të prapambetura, etj. Gjatë auditimit në terren janë të marrë të dhëna të mjaftueshme të cilat mundësojnë dhënien e opinionit.

Opinion i kualifikuar mbi përputhshmërinë

Sipas opinionit të KLSH-së, nga auditimi i përputhshmërisë¹, i mbështetur në ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

Shtetit”, standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, rezultuan disa devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur janë materiale por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e ***një opinionit të kualifikuar të përputhshmërisë***².

Baza për opinionin e kualifikuar (ISSAI 4000³)

Ne e kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs), ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, mbështetur në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së. Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar.

Ne arritëm në konkluzionin se, mangësitë e konstatuara të cilat lidhen kryesisht me, mungesën e kuadrit të plotë rregullator për miradministrimin financiar, kanë ndikime të rëndësishme në veprimtarinë institucionale, pasi dobësojnë procesin e planifikimit dhe monitorimit buxhetor si dhe ndikojnë në efikasitetin e sistemeve të kontrollit të brendshëm. Ndërkohë, akumulimi dhe mbartja në vijimësi e detyrimeve të prapambetura, e ekspozojnë njësinë publike drejt risqeve të vazhdueshme për pagesa penaltitësh kontraktuale, çka kërkon një vëmendje të shtuar në vijim.

II. HYRJA

¹ Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”

² Një opinion i kualifikuar shprehet kur efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje, nuk janë aq materiale sa të justifikojnë dhënien e opinionit të kundërt ose një refuzim të opinionit

³ ISSAI 4000 – Udhërrëfyeti i Auditimit të Përputhshmërisë



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

Mbështetur në Ligjin 154/2014 datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 807/1, datë 01.09.2020, i ndryshuar, u krye auditimi tematik “Mbi përputhshmërinë” në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, për periudhën nga 01.01.2013 deri 20.09.2020 me afat auditimi nga data 01.09.2020 - 25.10.2020, i cili u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

1. I.D, përgjegjës grupi
2. A.K, auditues
3. K.X, auditues

a) Objektivat dhe qëllimi i auditimit

Objekti i këtij auditimi tematik është Auditimi i fokusuar i detyrimeve të krijuara nga zbatimi i kontratave për ndërtimin e kampusit të ri universitar, planifikimi dhe realizimi i buxhetit të parashikuar dhe likuidimi i detyrimeve të prapambetura, në trajtim të ankesës së administruar në KLSH me nr. 723 prot, datë 24.07.2020.

Qëllimi i auditimit është dhënia e opinionit dhe hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse. Qëllimi i auditimit është të identifikojë dhe vlerësojë zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi si dhe vlerësojë risqet e anomalive materiale, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj. Çështjet të cilat do të trajtohen në këtë raport, lidhen me krijimin e detyrimeve të prapambetura nga zbatimi i kontratave sipas fokusit të auditimit. Ecuria e detyrimeve në vijimësi si dhe zbatimi i disiplinës buxhetore mbi parashikimin e investimeve dhe raelizimi i tyre. Raportimin e të gjitha çështjeve të tjera që dalin apo lidhen me auditimin, të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për t’u bërë publike.

b) Identifikimi i çështjes

Fushëveprimi i këtij auditimi është vlerësimi mbi detyrimet e krijuara me fokus detyrimet e krijuara gjatë ndërtimit të kampusit të ri universitar si dhe zbatimi i disiplinës buxhetore për to. Aktivitetet që do të jenë objekt vlerësimi nga ana e grupit të auditimit, janë parashikuar sipas drejtimeve të miratuara nga Kryetari i KLSH-së, në programin e auditimit, i ndryshuar.

c) Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim

Administratorit i Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi menaxherial është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

d) Përgjegjësia e Audituesve të KLSH

Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e detyrimeve kontraktuale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

e) Kriteret e vlerësimit

-Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”;

-Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;

-Ligji Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" ;

-VKM nr. 75 datë 12.02.2018 “Për Miratimin e Modelit të Financimit të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë dhe Shkencor”;

-VKM nr. 50, datë 05.02.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimt”, të ndryshuar” ;

-Udhëzimi nr. 5 datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, i ndryshuar;

-Udhëzimi nr. 7, datë 28.02.2018 të Ministrit të Financave “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”;

-Udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012 të Ministrit të Financave, “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar;

-Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 të Ministrit të Financave, “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”;

-Vendimit nr. 9 datë 15.04.2010 të Senatit “Për miratimin e Planit të Zhvillimit strategjik të UAMD”.

-Strategjisë së Zhvillimit dhe objektivave të UAMD, si dhe Strategjive të Zhvillimit të Fakulteteve për periudhën 2018-2020.

-Akte të tjera ligjore dhe nënligjore të detyrueshëm për zbatim.

f) Standardet e Auditimit

Auditimi u bazua në:

-Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI);

-ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik” ku përcaktohen parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;

-ISSAI 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”;

-INTOSAI-P10 “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e - SAI-t”, si dhe

-ISSAI 130 “Kodi i Etikës:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

g) Metodat e auditimit

Metodat dhe teknikat e kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit u bazuan kryesisht në metodologjinë e aplikuar gjatë fazës së planifikimit dhe të dhënave të vëna në dispozicion nga subjekti i audituar. Objektivi i audituesve ishte identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale që konsistoi në vlerësimin e kontrolleve të brendshme në institucion sa i takon:

(a) hartimit;

(b) implementimit; dhe

(c) funksionimit të të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Vlerësimi i kontrollit të brendshëm u krye nëpërmjet testeve të kontrolleve. Metodat dhe teknikat e kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit u bazuan kryesisht në;

-*Raporte dhe informacione* nga shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve që lidhen direkt me objektivat e auditimit të marra në formë elektronike dhe shkresore.

-*Kontrolli i vlerësimit* për të përcaktuar nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, në përputhje me vlerat e paraqitura në pasqyrën financiare.

-*Verifikimi i transaksioneve* duke marrë informacion shtesë nga burime të tjera verifikuese.

-*Inspektim fizik* dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse.

-*Intervistimi i personelit* që ka patur role specifike.

h) Dokumentimi i rezultateve të auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën, dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Rezultatet e këtyre procedurave, evidencat e marra gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale të bëra në arritjen e konkluzioneve u konsideruan të përshtatshme dhe të rëndësishme për të konfirmuar dhe mbështetur opinionin dhe raportin e audituesve dhe shërbyen si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, akt-konstatimet e lëna në subjekt, observacioneve të paraqitura nga subjekti Projekt Raportit të Auditimit, u hartua Raporti Përfundimtar i Auditimit.

III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm:

Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës, (UAMD) është institucion publik i arsimit të lartë i cili ushtron veprimtari mësimore, kërkimore shkencore dhe administrative. Univeristeteti është person juridik i krijuar me Vendimi e Këshillit të Ministrave nr. 801 datë 20.12.2005. Institucioni ushtron veprimtarinë e tij mbështetur në Ligjin nr. nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutin, dhe



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

Rregulloret e Brendshme si dhe akteve ligjore, nënligjore e rregullative që rregullojnë veprimtarinë e institucioneve publike.

Mbi Institucionet e Arsimit të Lartë

Institucionet publike të arsimit të lartë janë persona juridik publik që vetëfinancohen, financohen nga Buxheti i Shtetit ose nga burime të tjera të ligjshme. Ato gëzojnë liri akademike, autonomi financiare, organizative dhe të përzgjedhjes së personelit.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” shteti ushtron funksione rregullatore dhe krijuese të tyre, si dhe financon arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor. Kjo nëpërmjet vënies në dispozicion të fondeve publike për mbështetjen e programeve të studimit ose fushave të caktuara të kërkimit shkencor, si dhe fondeve publike për të garantuar aksesin e individëve në arsimin e lartë, pavarësisht nga mundësitë financiare të tyre.

-Organi më i lartë drejtues akademik në IAL është Senati Akademik ndërsa Autoritetet drejtuese akademike janë Rektori, drejtuesi i njësisë kryesore/Dekani, drejtuesi i njësisë bazë/Drejtuesi i Departamentit.

-Organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij është Bordi i Administrimit. Autoritetet drejtuese administrative janë, Administratori i institucionit dhe administratori i njësisë kryesore.

Institucionet publike të arsimit të lartë financohen nga:

- ✓ Buxheti i Shtetit;
- ✓ pagesat e studentëve për arsimim;
- ✓ të ardhurat për shërbimet e kryera;
- ✓ të ardhurat e krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta;
- ✓ donacione dhe burime të tjera të ligjshme financimi;
- ✓ veprimtari kërkimore-shkencore;

Fondet nga Buxheti i Shtetit shpërndahen në formë granti, sipas kategorive:

- granti i politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë;
- granti i mësimdhënies;
- granti i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese.

Auditime të mëparshme të KLSH^{së} në UAMD

Auditimi i mëparshëm nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, është kryer në zbatim të programit të auditimit nr. 1121/1 prot, datë 08.10.2018, për periudhën nga 01.01.2017 deri më 31.08.2018 dhe lloj auditimi “Auditim Financiar” i cili ka rezultuar me *opinion të pakualifikuar*.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve:

Drejtimi nr.1 “Vlerësimi i zbatimit të kontratave për ndërtimin e kampusit universitar”

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të zbatimit të vënë në dispozicion me objekt *"Vazhdim i ndërtimit të kampusit të ri universitar, godina dytë, për universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës "*, konstatohet:

- Objekti i kontratës *"Vazhdim i ndërtimit të kampusit të ri Universitar, godina dytë, për Universitetin 'Aleksandër Moisiu', Durrës "*, me vlerë 763,302,161.25 lekë me TVSH, është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 910/6 prot. 24.01.2013, të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, përfaqësuar nga Kancelari z. U.H dhe operatorit ekonomik "K.K" shpk, përfaqësuar nga Administratori z. S.G. Preventivi dhe lloji i kontratës është me çmim njësie, ku bazuar *nenit 6* të kontratës, preventivi do të përdoret për të llogaritur vlerën e kontratës, ku kontraktori paguhet me sasinë e punës e realizuar, me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh. Investimi konsiston në ndërtimin e një objekti i përberë nga tre godina me 1, 3 dhe 4 kat në kampusin e Universitetit si nevojë e shtimit të kapaciteteve akademike.

- Me amendimin e kontratës nr. 321 prot, datë 05.03.2015, palët kanë rënë dakord për shtyrje të afatit të punimeve me 12 muaj, bazuar në kërkesën nr. 143 prot. datë 22.01.2015 të sipërmarrësit, ku tregohet se nuk është bërë i mundur realizimi i punimeve për shkak se financimet e kryera nga autoriteti kontraktor janë të vogla dhe sipërmarrësit i është dashur të përshtatë punimet bazuar në planifikimin e buxhetit, pasi ai kryen punimet në bazë të pagesave të kryera nga autoriteti kontraktor.

- Me amendimin e kontratës nr. 58 prot. datë 14.01.2016, palët kanë rënë dakord për shtesë kontrate 17.76% të kontratës fillestare, bazuar në shkresën nr. extra prot. datë 10.06.2014 të mbikëqyrësit “Propozim tekniko-ekonomik për ndryshimet dhe mangësitë në projekt-preventiv, bazuar në urdhërin nr.69 prot. datë 12.06.2014 të Rektorit “Për ngritjen e grupit të punës....”, bazuar në vendimin nr. 577 prot. datë 19.06.2014 grupit të punës “Për miratimin e problematikave....”, bazuar në shkresën nr. 49 prot. datë 12.01.2016 të sipërmarrësit “Kërkesë për lidhje kontrate”. Sipas këtij amendimi tregohet se për punimet e paparashikuara dhe mangësitë në projekt-preventivin e objektit, të argumentuara teknikisht dhe ekonomikisht nga mbikëqyrësi i punimeve, është e domosdoshme lidhja e kësaj kontrate për përfundimin e objektit.

- Me amendimin e kontratës nr. 152/1 prot. datë 04.03.2016, palët kanë rënë dakord për shtyrje të afatit të punimeve me 12 muaj, bazuar në kërkesën nr. 45 prot. datë 15.02.2016 të mbikëqyrësit, ku problematika në furnizimin me energji elektrike në objekt, likuidimi pjesërisht i situacioneve dhe ditët me shi, kanë bërë të pamundur kryerjen e proceseve të punës sipas grafikut të punimeve.

- Me amendimin e kontratës nr. 1292 prot. datë 29.12.2016, palët kanë rënë dakord për shtesë kontrate 2.2% të kontratës fillestare, bazuar në shkresën nr. 1968 prot. datë 22.11.2016 të mbikëqyrësit “Preventiv i punimeve shtesë”. Sipas të cilit, gjatë zbatimit të punimeve janë konstatuar mangësi në volumet e preventivit dhe sasitë e parashikuara nuk janë të mjaftueshme për përfundimin e gjithë objektit.

- Me amendimin e kontratës nr. 209/1 prot. datë 06.04.2017, palët kanë rënë dakord për shtyrje të afatit të punimeve me 6 (gjashtë) muaj, bazuar në kërkesën nr. 209 prot. datë 23.02.2017 të



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

mbikëqyrësit “Kërkese për shtyrje afati”, ku tregohet se mungesa e energjisë elektrike në objekt, dhe ditët me shi, kanë bërë të pamundur kryerjen e proceseve të punes sipas grafikut të punimeve.

- Me amendimin e kontratës nr. 803 prot. datë 11.09.2017, palët kanë rënë dakord për shtyrje të afatit të punimeve nga data 06.09.2017 deri 14.02.2018, bazuar në kërkesën nr. 201 prot. datë 04.09.2017 te sipërmarrësit, bazuar në kërkesën nr. 1082/1 prot. datë 06.09.2017 te mbikëqyrësit “Kërkese për shtyrje afati”, arsyet e shtyrjes se afatit janë për shkak së gjatë zbatimit të projektit kanë dalë probleme teknike të cilat kane kërkuar ndërhyrjen e projektuesit.

- Me amendimin e kontratës nr. 212 prot. datë 14.02.2018, palët kanë rënë dakord për shtyrje të afatit të punimeve nga data 14.02.2018 deri 14.04.2018, bazuar në kërkesën nr. 197 prot. datë 13.02.2018 të mbikëqyrësit. Arsyet e shtyrjes se afatit te punimeve janë së gjatë zbatimit të projektit në zërin ‘sistemime te jashtme’ dhe ndërtimin e rrugëve lidhëse, shtresa asfaltike, kanë patur pengesa në reshje të cilat nuk kane lejuar zhvillimin e punimeve.

- Me amendimin e kontratës nr. 632 prot. datë 27.04.2018, palët kanë rënë dakord për shtyrje të afatit të punimeve nga data 14.04.2018 deri 16.05.2018, bazuar në kërkesën nr. 400 prot. datë 25.04.2018 të mbikëqyrësit. Arsyet e shtyrjes se afatit te punimeve janë së gjatë periudhës shkurt-prill ka patur dite me shi dhe nivel të larte të ujërave nëntokësore, duke bërë të nevojshme vendosjen e elektropompave për heqjen e ujërave dhe pamundësi për pastrimin e terrenit.

- Me amendimin e kontratës nr. 744 prot. datë 16.05.2018, palët kanë rënë dakord për shtyrje të afatit të punimeve nga data 16.05.2018 deri 14.07.2018, bazuar në kërkesën nr. 447/1 prot. datë 10.05.2018 të mbikëqyrësit. Arsyet e shtyrjes se afatit te punimeve janë lidhja e kontratës shtesë me mbikëqyrësin e punimeve, për punimet shtesë të kontratës nr. 1292 prot. datë 29.12.2016.

- Për mbikëqyrjen e kontratës së zbatimit është lidhur kontrata nr. 105/4 prot. datë 08.03.2013 të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës, nga Kancelari z. U.H dhe operatorit ekonomik “G. & C.O” sh.p.k, i përfaqësuar nga drejtuesi ligjor z. H.M. Sipas *nenit 3* te kësaj kontrate, afati i mbikëqyrjes shtrihet paralelisht me afatin e kontratës se lidhur ndërmjet Investitorit dhe Sipërmarrësit për zbatimin e objektit duke përfshirë dhe shtyrjet e mundshme të afatit që mund të lindin.

-Kontrata shtesë e mbikëqyrjes së punimeve nr. 888 Prot, date 28.09.2017, lidhur midis të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës, nga Kancelari z. U.H dhe operatorit ekonomik “G. & CO” sh.p.k i përfaqësuar nga drejtuesi ligjor z. H.M, me objekt drejtimin e punimeve te zbatimit te objektit *“Vazhdim i ndërtimit të kampusit te ri Universitar, godina dyte, per Universitetin ‘Aleksandër Moisiu’, Durrës ”*

- Akti i dorëzimit të sheshit të punimeve mbajtur midis palëve është bere më datë 09.03.2013. Akti i piketimit të objektit është realizuar më datë 11.03.2013. Njoftimi dhe Procesverbali i fillimit të punimeve jane mbajtur me datë 11.03.2013 nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve dhe investitori, ku konstatojnë se punimet kanë filluar më 11.03.2013.

Midis palëve ekzistojnë shumë korrespondenca mbi problematika teknike që janë hasur gjatë zbatimit te projektit, duke sjellë si pasojë vonesa në përfundimin e punimeve. Përfundimi i punimeve sipas njoftimit për përfundim punimesh nr. 1094, datë 13.07.2018 është më datë 13.07.2018, brenda afateve kontraktuale.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

- Bazuar ne Proces Verbalin mbi Përdorimin e Fondit Rezerve (3.5%) mbajtur midis palëve ne date 01.07.2016 është miratuar përdorimi i fondit rezerve në vlerën 19,522,710 lekë me TVSH, ku është argumentuar se është e nevojshme të përdoret fondi rezerve sipas punimeve shtesë të dala gjatë zbatimit te punimeve.

- Akti i kolaudit është realizuar më datë 24.09.2018, nga kolaudatori "A. E" shpk, me drejtues ligjor dhe teknik Ing. A.S. Certifikata e përkohshme e marrjes në dorëzim të punimeve e mbajtur midis palëve, më datë 24.09.2018, ku ka filluar edhe periudha e garancisë së punimeve prej 12 muajsh, ku nga AK është mbajtur shuma e garancisë 5% në vlerën 38,165,106.6 lekë me TVSH. Nga kontabiliteti është bërë kapitalizimi i aktivitetit (pasi është vënë në funksionim), ku është bërë hyrje godina duke debituar llogarinë 212 “Ndërtime Konstruksiione” dhe duke kredituar llogarinë 231, “Investime për aktive afatgjata materiale”.

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës, në vitin akademik 2018 – 2019, vuri në shfrytëzim një godinën e re universitare në të cilën zhvillojnë procesin mësimor dy fakultete me rreth 8,000 studentë.

Përmbledhje e vlerave të kontratave:

1. Kontrata nr. 910/6 prot., datë 24.01.2013 me objekt “Vazhdim i ndërtimit të kampusit të ri universitar në zonën Spitallë, Durrës, godina nr.2”, me vlerë 636,303,341 lekë

2. Kontrata nr. 58/1, datë 14.01.2016 me objekt “Shtesë e kontratës nr. 910/6, datë 24.01.2013” në vlerën 113,000,638 lekë

3. Kontrata nr. 1292 datë 29.12.2016 me objekt “Shtesë kontratës nr. 910/6, datë 24.01.2013”, në vlerën 14,020,363 lekë.

Vlera totale e kontratave (përfshirë edhe dy kontratat shtesë) është në shumën **763,324,342 lekë**.

Financimi i këtij investimi realizohet nga buxheti i shtetit (Fondi për Zhvillimin e Rajoneve) dhe nga të ardhurat e vet Institucionit. Vlera e punimeve ndërtimore të realizuara është 763,302,063 lekë. Pas përfundimit të afatit ligjor të garancisë së punimeve subjektit i është çliruar edhe vlera e ngurtësuar pranë Degës së Thesarit, Durrës, si “garanci për difekte punimesh”, por gjatë periudhës së garancise se punimeve të kësaj godine eshte mbajtur korespondence e vazhdueshme mes Institucionit dhe subjektit zbatues ne lidhje me problematika të konstatuara në këtë godinë.

- Autoriteti Kontraktori me shkresën Nr. 45 Prot. Datë 11.01.2019 i drejtohet OE “K. C” Shpk për disa problematika që janë konstatuar për punimet e kryera për ndërtimin e Godinës Nr.2 të Kampusit Universitar, sipas memos Nr. 1 datë 09.01.2019 hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme. Operatori ekonomik “K. C” Shpk është përgjegjgur me shkresën Nr.13 datë 18.01.2019, protokolluar me Nr.45/1 Prot. Datë 23.01.2019 pranë Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, nëpërmjet të cilës njofton ngritjen e grupeve të punës pasi e gjejnë kërkesën e autoritetit kontraktor të bazuar. Subjekti pranon se kanë kryer punime për ndreqjen e problematikave për të cilat nuk është shprehur mbikëqyrësi i punimeve.

- Në zbatim te Vendimit Nr. 34 datë 20.05.2019 të Senatit Akademik të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, si dhe shkresës Nr. 356 Prot. Datë 07.06.2019 të Shoqërisë “G. & CO” sh.p.k me objekt “Mbi marrjen e masave për riparimin e defekteve të shfaqura dhe monitorimin e punimeve të kryera gjatë gjithë periudhës se garancise”, është ngritur grupi i



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

përbashkët i punës me përfaqësues të Universitetit, shoqërisë mbikëqyrëse “G. & CO” sh.p.k, dhe shoqërisë sipërmarrëse K.C” Shpk.

Grupi i punës ka mbajtur procesverbal për defektet dhe problematikat e konstatuara dhe supervizori G.& CO” sh.p.k, ka përcaktuar detyrat konkrete dhe afatet kohore për zbatimin e tyre. Shoqëria G. & CO” sh.p.k, në cilesinë e mbikëqyresit të punimeve ka hartuar shkresën Nr. 361 Prot. Datë 12.06.2019, protokolluar pranë UAMD me Nr. 994/1 datë 13.06.2019 me objekt “Mbi konkluzionet dhe detyrat e lëna gjatë kontrollit të ushtruar në kantierin e ndërtimit “Vazhdimi i Ndërtimit të Kampusit të ri Universitar , Godina e II-të e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës”.

Në këtë shkresë, mbikëqyrësi konstaton problematikat dhe i lë për detyrë Shoqërisë “K.C.” Shpk të kryejë riparimet e të gjitha defekteve të konstatuara për një afat deri në përfundimin e periudhës 12 mujore të garancisë së punimeve. Me shkresën Nr. 235 Prot dt. 07.10.2019 të Shoqëria “K. C.” Shpk, kërkon marrjen në dorëzim të Godinës Nr. 2 të Kampusit Universitarë në Spitalë dhe çlirimin e garancisë.

Në lidhje me likuidimin e punimeve ndërtimore të realizuara sipas kontratës nr. 910/6, datë 23.01.2013, dhe shtesë kontratave të lidhura Vlera e punimeve ndërtimore të palikujduara lidhur me këto kontrata është aktualisht 0 (zero) lekë.

Në tabelën nr. 1 më poshtë paraqiten likuidimet e kësaj kontrate ndër vite sipas burimit të financimit.

Tabela nr.1			
Mbi financimet referuar kontratës bazë dhe shtesave në të:			
Periudha e pagesës	Financimi nga buxheti (lekë)	Financimi nga te ardhurat (lekë)	Gjithsej (lekë)
Viti 2013	54,507,425	9,981,226	64,488,651
Viti 2014	60,000,000	43,980,314	103,980,314
Viti 2015	39,730,476	45,000,000	84,730,476
Viti 2016	90,781,328	114,600,000	205,381,328
Viti 2017	40,000,000	62,000,000	102,000,000
Viti 2018	50,000,000	31,000,000	81,000,000
Viti 2019		6,665,992	6,665,992
Viti 2020	111,055,120		111,055,120
Likujduar gjithsej	446,074,349	313,227,532	763,301,881
Debia e mbetur	0		

Burimi: UAMD, përpunuar nga grupi i auditimit

Në tabelën nr.2 më poshtë paraqitet në mënyrë kronologjike financimi i çdo situacioni të kontratës bazë për ndërtimin e objektit.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

Tabela nr.2				
Tabela përmbledhese e situacioneve të kontratës nr 910/6 date 24.01.2013 dhe likuidimi i tyre.				
Kotrata Bazë Nr 910/6 Dt 24.01.2013				
Situacioni nr.	Vlera e situacionit	Financimi nga buxheti	Financimi nga te ardhurat	Debia me 31.08.2020
1	54,493,080	54,493,080		-
2	9,995,571	14,345	9,981,226	-
3	20,300,000	20,300,000		-
4	10,609,294	10,609,294		-
5	30,058,058	29,090,706	967,352	-
6	43,012,962		43,012,962	-
7	20,517,541	20,517,541		-
8	19,417,167	684,915	18,732,252	-
9	21,966,486	2,698,738	19,267,748	-
10	20,727,576	10,727,576	10,000,000	-
	18,751,901	17,814,306	937,595	-
12	30,391,124	14,615,005	15,776,119	-
13	28,161,182	3,161,182	25,000,000	-
14	15,635,988	15,635,988		-
15	9,678,490	9,678,490		-
16	34,500,000	34,500,000		-
17	12,000,000	1,400,000	10,600,000	-
18	40,000,000		40,000,000	-
19	20,000,000		20,000,000	-
20	10,100,000	100	10,000,000	-
21	20,000,000		20,000,000	-
22	33,153,331	16,153,331	17,000,000	-
23	26,876,873	11,876,873	15,000,000	-
24	16,700,000	16,700,000		-
25	6,585,947	6,585,947		-
26	7,350,489	7,350,489		-
27	20,051,691	357,846	19,693,845	-
28	7,907,048		7,907,048	-
29	9,410,952		7,000,000	2,410,952
30	3,065,099		3,065,099	-
Perfundimtar	14,885,491			14,885,491
SHUMA	636,303,341	305,065,652	313,941,246	17,296,443

Burimi: UAMD, përpunuar nga grupi i auditimit

Në tabelën nr.3 më poshtë paraqitet në mënyrë kronologjike financimi i çdo situacioni për shtesë kontratën nr.1 për ndërtimin e objektit.

Tabela nr.3
Tabela përmbledhese sipas situacioneve të kontratës nr 58/1 date 14.01.2016 dhe likuidimi i tyre



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

Situacioni nr.	Vlera e situacionit	Financimi nga buxheti	Financimi nga te ardhurat	Debia
1	5,269,813	5,269,813		-
2	15,414,310	15,414,310		-
3	8,555,740	8,555,740		-
4	46,742,695	42,742,695	4,000,000	-
5	10,461,142	7,257,305		3,203,837
6	26,556,742			26,556,742
SHUMA	113,000,442	79,239,863	4,000,000	29,760,579

Burimi: UAMD, përpunuar nga grupi i auditimit

Në tabelën nr.4 më poshtë paraqitet në mënyrë kronologjike financimi i çdo situacioni për shtesë kontratën nr.2 për ndërtimin e objektit.

Tabela nr.4				
Tabela përmbljedhese sipas situacioneve të kontratës nr 1292 date 29.12.2016 dhe likuidimi i tyre				
Situacioni nr.	Vlera e situacionit	Financimi nga buxheti	Financimi nga te ardhurat	Debia
1	9,410,952			9,410,952
2	4,587,146			4,587,146
SHUMA	13,998,098	-	-	13,998,098

Ne tabelën nr.5 më poshtë paraqitet ecuria mbi pagesat e detyrimeve për ndërtimin e objektit.

Tabela nr.5	Vlera në lekë
Totali i punimeve sipas situacioneve	763,301,881
TOTALI paguar deri me 30.09.2020	763,301,881
Debia me 31.08.2020	61,055,120
Paguar Shtator 2020	61,055,120
DEBIA AKTUALE	0

Burimi: UAMD, përpunuar nga grupi i auditimit

Detyrimi i prapambetur ndaj subjektit “K. C.” sh.p.k.për likuidimin e punimeve ndërtimore të realizuara në zbatim të kontratës nr. 910/6 dt. 24.01.2013 dhe amendamenteve të saj në fund të vitit 2018 ishte 121,721,294 lekë, në përfundim të vitit 2019 ishte 115,055,120 lekë dhe aktualisht kjo vlerë është e likuiduar pra rezulton 0 (zero) lekë.

- Likuidimi i menjëhershëm i të gjitha vlerave ndaj subjektit sipas shpjegimeve të institucionit ka qenë jashtë mundësive financiare të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës. Këtë problem ky Institucion e ka bërë prezent edhe pranë MASR nëpërmjet shkresës nr. 1308/2, datë 14.12.2018 me objekt “Kërkese për likuidimin e detyrimeve të prapambetura”, shkresës nr. 331 prot., datë 21.02.2019, shkresës nr. 1021 prot., datë 07.06.2020, shkresës nr. 1478 prot., datë 17.09.2019,



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

shkresës nr. 687 prot., datë 12.06.2020, shkresës nr. 877/1, datë 23.07.2020 dhe diskutimeve të vazhdueshme me MARS.

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, aktiviteti ekonomik – financiar i Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës financohet nga buxheti i shtetit (në formën e grantit) dhe nga të ardhurat e veta. Detajimi dhe përdorimi i buxhetit dhe të të ardhurave realizohet sipas propozimit të Senatit Akademik dhe miratimit në Bordin e Administrimit. Bordi i Administrimit, si organi kolegjal drejtues më i lartë administrativ i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë dhe mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij ka mbikqyrur dhe administruar me kujdes situatën financiare të Institucionit.

- Likuidimi i menjëhershëm dhe në afat i detyrimeve në lidhje me punimet ndërtimore të realizuara nga subjekti ka qenë jashtë kapaciteve financiare të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës sepse gjatë kësaj periudhe 2018-2020. Institucioni ka financuar nga të ardhurat e veta shpenzimet për pagat për personelin me kohë të plotë për dy muaj, shpenzimet për personelin akademik me kohë të pjesshme, shpenzimet operative për funksionimin normal të Institucionit dhe shpenzime për investime të domosdoshme të miratuara me Vendim të organeve kolegjiale. Institucioni nga të ardhurat e tij financon në të njëjtën kohë likuidimin e shpenzimeve prioritare për funksionimin normal të Institucionit, shpenzime për mos krijimin e detyrimeve të prapambetura, financimin e aktivitetit kërkimor shkencor, të mbështesë studentët në nevojë si dhe të shlyejë detyrimet e prapambetura.

- Bordi i Administrimit të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, me synimin për të likuiduar/pakësuar detyrimet e prapambetura, si dhe në zbatim të Vendimit nr. 11, datë 14.02.2019 të Senatit Akademik, miratoi me vendim nr. 9, datë 19.02.2019 që 83,734,170 lekë ose 21 % të të ardhurave të pritshme të vitit 2019, të përdoren për likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe investime të tjera të domosdoshme. Për vitin 2020, Bordi i Administrimit, në zbatim të Vendimit nr. 3, datë 17.01.2020 të Senatit Akademik të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, me vendim nr. 4, datë 14.02.2020 miratoi që **66,000,000** lekë ose 30% e të ardhurave të pritshme të vitit 2020, të përdoren për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

Sa më sipër, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës nga të ardhurat e veta i ka vënë prioritet likuidimit të detyrimeve të prapambetura si dhe financimin e shpenzimeve më të domosdoshme për një funksionim normal të Institucionit, duke mos krijuar detyrime të reja. Gjatë kësaj periudhe nuk është ndërmarrë asnjë angazhim buxhetor i cili ka vënë në rrezik qëndrueshmërinë financiare të Institucionit.

Nga ana tjetër, detyrimet e sipërmarrësve krijojnë rrisqe të medha financiare në bazë të kontratës dhe legjislacionit në fuqi si më poshtë:

Në bazë të **Neni 29** të kontratës "Vonesën në bërjen e pagesës, citohet se:

29.1. Shpërblimi për dëmet e shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë konsiston në kamaten e arritur nga data e fillimit të vonesës së debitorit (Autoriteti Kontraktor), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti kamatat e arrira i shtohen shumës totale, mbi të cilën është bërë llogaritja e tyre.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

29.2 Kamata ligjore paguhet pa qenë i detyruar kreditori (kontraktori) të provojë ndonjë dëm. Nëse kreditori (kontraktori) provon se ka pësuar një dëm më të madh se kamata ligjore, debitori (Autoriteti Kontraktor) duhet të paguajë pjesën e mbetur të dëmit.

Bazuar në ligjin Nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet Kontraktore e tregtare "Neni" 6: Afati citon se :

Kur nga kontrata apo nga ndonjë dispozitë tjetër ligjore nuk mund të përcaktohet ndonjë afat a datë për kryerjen e pagesës, llogaritja e kamatëvonesës fillon nga data, në të cilën debitori nuk ka ekzekutuar detyrimin e tij, të kërkuar nga kreditori, sipas parashikimeve të nenit 463 të Kodit Civil. **(Neni 463 Afati i ekzekutimit të detyrimit. Ekzekutimi i detyrimit duhet të bëhet në afatin e caktuar në kontratë. Kur në kontratë nuk është caktuar afat ose ekzekutimi i detyrimit është lënë në kërkimin e kreditorit, ky mund të kërkojë ekzekutimin në çdo kohë dhe debitori duhet ta ekzekutojë atë brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga dita e kërimit.)**

Në ato raste kur debitori ka refuzuar të marrë në dorëzim mallin apo kryerjen e shërbimeve, për shkak të pretendimeve që ai ka mbi to, afatet e parashikuara në këtë nen llogariten duke filluar nga data e rënies dakord ndërmjet kreditorit dhe debitorit për pranimin e mallrave, punimeve apo shërbimeve të kryera nga kreditori. Në rastet kur afati i pagesës nuk është i përcaktuar në kontratë, pas mbarimit të afatit të ekzekutimit të detyrimit nga debitori, sipas nenit 463 të Kodit Civil, kreditori ka të drejtë të marrë kamatëvonesë, duke filluar nga përfundimi i afateve si më poshtë:

- a) 30 ditë kalendarike pas datës së marrjes prej debitorit të faturës ose të një kërkesë-pagese të njëvlershme;
- b) 30 ditë kalendarike pas datës së marrjes së mallrave ose shërbimeve, kur nuk është e qartë data e marrjes së faturës ose kërkesëpagesës së njëvlershme;
- c) kur debitori e merr faturën ose kërkesëpagesën e njëvlershme përpara lëvrimit të mallrave ose shërbimeve, 30 ditë kalendarike pas datës së marrjes së mallrave ose shërbimeve;
- ç) kur ligji a kontrata parashikon një procedurë të marrjes në dorëzim ose të kolaudimit, përmes së cilës vërtetohet përputhshmëria e mallrave a shërbimeve me kontratën dhe nëse debitori e merr faturën ose kërkesëpagesën e njëvlershme përpara ose në datën kur bëhet marrja në dorëzim apo kolaudimi në fjalë, 30 ditë kalendarike pas kësaj date. Afati i parashikuar në shkronjën “a” të këtij neni, mund të zgjatet jo më shumë se 60 ditë kalendarike. Fletore Zyrtare nr.70, datë 20 maj 2014 Afatet për kryerjen e pagesave nuk mund të jenë më të gjata se 60 ditë nga data e parashikuar në shkronjën “a” të këtij neni. Në ato raste kur me kontratë apo në marrëveshje me palët është caktuar një afat tjetër, ky afat konsiderohet i vlefshëm, me përjashtim të rasteve kur dëmton dhe vë në pozitë diskriminuese kreditorin.

Në nenin 5 të ligjit Nr.48/2014 Llogaritja e kamatëvonesës citohet: “Llogaritja e Kamatëvonesës”, subjekti ka të drejtë të kërkojë përveç detyrimeve edhe shlyerjen e kamatëvonesave.

Si konkluzion: Mospagesa në afat e detyrimeve e ekspozon institucionin drejt risqeve për pagesë të kamatëvonesave të cilat do të rëndojnë padrejtësisht buxhetin e Institucionit, çka kërkon një qasje kujdesshme nga hallkat përgjegjëse në vijim.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraportit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni i regjistruar në KLSH me shkresën nr.807/3, datë 01.10.2020 në të cilën janë shprehur objeksionet lidhur me Akt-Konstatimin nr. 1 si më poshtë vijon:

Pretendimi i subjektit:

Në zbatim të shkresës nr. 17232/1 prot, datë 18.09.2020 të MFE, është miratuar fondi prej 61,055,120 lekë në zërin shpenzime kapitale për godinën e re, Menjëherë pas miratimit të këtij fondi institucioni likujdoi plotësisht detyrimin e mbetur i cili aktualisht është 0 (zero) lekë.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Referuar kontratave përkatëse dhe likuidimeve të kryera përfshirë dhe likuidimin e sipërpërmendur të miratuar më datë 18.09.2020, janë përmbyllur detyrimet për shoqërinë ndërtuese të kampusit. Për sa më sipër observacioni merret në konsideratë nga ana jonë.

Drejtimi nr. 2 “Mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit të Institucionit”

Në zbatim të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë.

- Projekt buxhetet afatmesëm të hartuar nga institucioni dhe Vendimet për miratimin e tyre;
- Vendime të institucionit për miratimin dhe detajimin e buxheteve vitet 2013-2020;
- Akt-rakordimi me degën e Thesarit për “Të Ardhurat dhe Shpenzimet” datë 31.12.2013;
- Akt-rakordimi me degën e Thesarit për “Të Ardhurat dhe Shpenzimet” datë 31.12.2014;
- Akt-rakordimi me degën e Thesarit për “Të Ardhurat dhe Shpenzimet” datë 31.12.2015;
- Akt-rakordimi me degën e Thesarit për “Të Ardhurat dhe Shpenzimet” datë 31.12.2016;
- Akt-rakordimi me degën e Thesarit për “Të Ardhurat dhe Shpenzimet” datë 31.12.2017;
- Akt-rakordimi me degën e Thesarit për “Të Ardhurat dhe Shpenzimet” datë 31.12.2018;
- Akt-rakordimi me degën e Thesarit për “Të Ardhurat dhe Shpenzimet” datë 31.12.2019;
- Akt-rakordimi me degën e Thesarit për “Të Ardhurat dhe Shpenzimet” datë 30.09.2020;
- Të tjera dokumentacione të nevojshme.

Mbi hartimin dhe zbatimin të buxhetit sipas periudhave:

Kërkesat buxhetore afatmesme (PBA) dhe zbatimi i buxheteve të miratuara hartohen në zbatim të akteve ligjore:

- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;
- Ligjet për miratimin e buxhetit vjetor;
- VKM nr. 75 datë 12.02.2018 “Për Miratimin e Modelit të Financimit të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë dhe Shkencor”;
- Udhëzimi nr. 7, datë 28.02.2018 të Ministrit të Financave “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”;
- Udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012 të Ministrit të Financave, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar;



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

- Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 të Ministrit të Financave, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”;
 - Vendimit nr. 9 datë 15.04.2010 të Senatit “Për miratimin e Planit të Zhvillimit strategjik të UAMD”.
 - Strategjisë së Zhvillimit dhe objektivave të UAMD, si dhe Strategjive të Zhvillimit të Fakulteteve për periudhën 2018-2020.
 - Shkresave të Administratorit drejtuar Njërive Kryesore mbi hartimin e kërkesave Buxhetore Afatmesme
 - Shkresave të paraqitur nga çdo njësi kryesore mbi hartimin e PBA-së;
 - Vendimit të Senatit Akademik, për çdo vit ku miratohet Draft PBA-ja e cila i përcillet Bordit të Administrimit për shqyrtim dhe miratim përfundimtar;
 - Formularëve standart të Aneksit 7 A. PBA 2020-2022 dërguar nga MAS sipas shkresave përkatëse: -Të tjera akte ligjore, nënligjore e rregullativë:
- Nisur nga fakti se institucioni është audituar nga KLSH deri më datë 31.12.2017 si dhe tematikës së fokusuar të këtij auditimi, grupi i auditimit u përqëndrua kryesisht në zbatimin e buxhetit për investimet për periudhat 2013-2017, ndërsa u trajtua dhe hartimi i PBA-ve për periudhën 2018-2020.*

VITI 2013

Granti i miratuar për UAMD për vitin 2013 ishte parashikuar në vlerën 224,127,700 leke dhe fondi për bursa ishte në vlerën 38,325,291 lekë.

Me vendim nr. 1 datë 09.01.2013 të Këshillit të Administrimi granti është detajuar:

- 188,127,700 lekë për shpenzime për paga;
- 31,000,000 lekë për shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore;
- 5,000,000 lekë për shpenzime operative;

Me shkresën nr. 2 datë 09.01.2013 detajimi dërgohet MFE.

Me shkresën nr. 20413/97 date 14.01.2013 të MFE dërgohet buxheti për vitin 2013 i përberë nga 224,127,700 lekë grant dhe 35,500,000 lekë shpenzime për bursa.

Me shkresën nr 320/1 datë 15.01.2013 MFE dërgon miratimin mbi detajimin e grantit viti 2013.

Me shkresën nr 320/2 datë 24.01.2013 MFE miraton limitet mujore mbi përdorimin e grantit viti 2013.

Me shkresën nr. 1453/3 date 08.04.2013 MASR i akordon UAMD-së fondin në vlerën 254,125,572 lekë për shpenzime për investime, në zbatim të shkreses nr. 4924/1 datë 01.04.2013 të MFE-së.

Me shkresën nr. 4924/2 të MFE miratohen limitet mujore për përdorimin e fondit më sipër.

Me shkresën nr. 6359/1 date 22.04.2013 të MFE-se miratohet fondi prej 335 921 lekësh për shpenzime për rimbursim tvsh-je për projekte te huaja.

Me shkresën nr. 898/2 datë 06.12.2013 të MAS shtohet fondi i bursave në vlerën 2 825 291 lekë.

Plani buxhetor i rishikuar për UAMD më 31.12.2013 paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Në lekë

Art.	Emërtimi	Tit09450, K1	Tit09770, K4	Tit09450, K8	Totali
------	----------	--------------	--------------	--------------	--------



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

231	Plani vjetor	254,125,572	335,921		254,461,493
600	Plani vjetor	-	-	188,127,700	188,127,700
601	Plani vjetor	-	-	31,000,000	31,000,000
602	Plani vjetor	-	-	5,000,000	5,000,000
606	Plani vjetor	38,325,291	-	-	38,325,291
TOTALI		292,450,863	335,921	224,127,700	516,914,484

Burimi: UAMD, përpunuar nga grupi i auditimit

Për vitin 2013, fondi i rishikuar i planifikuar nga buxheti i shtetit, për financimin e aktivitetit financiar, është në vlerën 516,914,484 lekë i përbërë nga :

224,127,700 nga granti financim i dhënë në formën e transfertës së pakushtëzuar, 38,325,291 lekë nga fonde buxhetore për bursa dhe 254,461,493 fonde buxhetore për investime.

Granti buxhetor për vitin 2013, është i detajuar sipas planeve buxhetore të detajuara si më poshtë:

- ✓ Plani vjetor buxhetor në zërin “Shpenzime për paga” është 188,127,700 lekë ose 36.4% e fondeve buxhetore vjetore.
- ✓ Plani vjetor buxhetor në zërin “Shpenzime për kontribute për sigurime shoqërore” është 31,000,000 lekë ose 6 % e fondeve buxhetore. Plani vjetor buxhetor në zërin “Shpenzime operative” është 5,000,000 lekë.
- ✓ Plani vjetor buxhetor në zërin “Shpenzime për bursa” është 38,325,291 lekë.
- ✓ Plani vjetor në zërin “Investime me financim nga granti konkurrense” është 254,125,572 lekë.
- ✓ Plani vjetor në zërin “Investime për bashkëfinancim në projekte, (rimbursim TVSH-je) në kuadër të projektit TEMPUS” është 335,921 lekë

Aktiviteti financiar (realizimi faktik), për periudhën 01 janar – 31 dhjetor 2013, për UAMD, është në vlerën 942,526,327 lekë, i financuar në vlerën 516,914,484 lekë nga buxheti i shtetit për vitin 2013 dhe 425,611,843 lekë nga të ardhurat e Institucionit. Bazuar në sa më sipër konstatohet se aktiviteti financiar është financuar në masën **54.5 %** nga buxheti i shtetit dhe **45.5 %** nga të ardhurat e Institucionit.

Tabela mbi realizimin e shpenzimeve Viti 2013

Në lekë



KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

Art	Emërtimi	Fondet e Buxheti	Fonde nga të ardhura			Fondet e Buxheti	Granti	Totali
		Tit09450, K1-k1	Tit09770, K6	Tit09450, K6		Tit09770, K4	Tit09450, K8	
230	Plan	-	-	6,432,309	-	-	-	6,432,309
	Fakt	-	-	6,430,680	-	-	-	6,430,680
231	Plan	-	-	198,301,994	335,921	254,125,572		452,763,487
	Fakt	-	-	195,430,987	335,921	254,125,572		449,892,480
600	Plan	-	-	201,991,754	-	188,127,700		390,119,454
	Fakt	-	-	166,944,948	-	188,127,700		355,072,648
601	Plan	-	-	17,132,460	-	31,000,000		48,132,460
	Fakt	-	-	14,274,085	-	31,000,000		45,274,085
602	Plan	-	747,5	46,969,732	-	5,000,000		52,717,232
	Fakt	-	489,46	36,472,632	-	5,000,000		41,962,092
606	Plan	38,325,291	-	7,852,544	-	-		46,177,835
	Fakt	38,325,291	-	5,569,051	-	-		43,894,342
Totali	Plan	38,325,291	747,5	478,680,793	335,921	478,253,272		996,342,777
	Fakt	38,325,291	489,46	425,122,383	335,921	478,253,272		942,526,327

Burimi: UAMD, përpunuar nga grupi i auditimit

Shpenzime buxhetore në zërin “Investime” me financim nga buxheti i shtetit

Projektet me financim nga buxheti i shtetit për vitin 2013 janë realizuar si më poshtë:

1. Ndertimi i godinës së parë të kampusit të ri Universitar: Fondi i miratuar nga FZHR për vitin 2013 për financimin e këtij projekti është në vlerën 199,618,147 lekë. Fondi i miratuar për vitin 2013 është përdorur 100 %.
2. Ndertimi i godinës së dytë të kampusit të ri Universitar. Punimet e ndërtimit për realizimin e këtij projekti filluan në janar të vitit 2013 dhe pritej të përfundonin në vitin 2015. Projekti do të financohet nga fondet buxhetore (FZHR) dhe nga të ardhurat e Institucionit. Fondi i miratuar nga FZHR për vitin 2013 për financimin e këtij projekti është në vlerën 54 507 425 lekë. Fondi i miratuar për vitin 2013 është përdorur 100 %.
3. Gjithashtu në vitin 2013 u miratua edhe fondi prej 335,921 lekë si bashkëfinancim për rimbursim të tvsh-së në realizimin e blerjes së pajisjeve në kuadër të projektit TEMPUS.

Nga të ardhurat e veta janë financuar për vitin 2013 aktive të qëndrueshme të trupëzuara në vlerën 195,430,987 lekë ose rreth 46 % të të ardhurave të përdorura. Sqarojmë se, 20,816,470 lekë janë shpenzuar për të likuiduar detyrimin e trashëguar nga viti 2012, dhe 2,664,000 lekë detyrim për likuidimin e sistemit të menaxhimit të dhënave të studentëve, 1,651,606 lekë blerje pajisje të ndryshme. Rreth 80% e të ardhurave të përdorura për financimin e shpenzimeve për aktive të trupëzuara janë përdorur për investime në fushën e ndërtimit ndërsa 20% janë përdorur për blerje orendish.

VITI 2014

Granti i miratuar për UAMD për vitin 2014 ishte parashikuar në vlerën 287,520,000 lekë dhe fondi për bursa ishte në vlerën 35,500,000 lekë.

Këshilli i Administrimit (KA) me Vendim nr.1 datë 10.01.2014 është detajuar:

- 251,520,000 lekë për shpenzime pagash
- 30,000,000 lekë për shpenzime kontributesh sigurimesh shoqërore dhe shëndetësore



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

- 6,000,000 lekë për shpenzime operative

Me shkresën nr. 2 datë 10.01.2014 i dërgohet MFE vendimi i KA nr.1 datë 10.01.2014.

Këshilli i Administrimit me vendim nr 3, date 20.01.2014 miraton detajimin dhe përdorimin e të ardhurave të pritshme të vitit 2013.

Me shkresën nr. 9243/14 date 02.07.2014 të MAS akordohen fondet për shpenzime për investime në zbatim të vendimit nr.9 datë 23.06.2014 të Komitetit të Detyrimeve të Prapambetura.

Me shkresën nr. 12555/23 datë 30.09.2014 me objekt “Mbi zbatimin e aktit normativ nr.1 datë 17.09.2014” u miratua granti shtesë në vlerën 8,187,000 lekë.

Me vendimin nr. 17 datë 14.10.2014 të KA ky grant është detajuar;

2,187,000 lekë për shpenzime për paga

6,000,000 lekë për shpenzime për sigurime shoqërore

Me shkresën nr. 25 datë 15.10.2014 të KA i dërgohet MFE vendimi nr. 17 datë 14.10.2014.

Me shkresën nr. 14212/1 date 20.10.2014 të MFE dërgohet miratimi i detajimit të grantit shtesë sipas vendimit nr 17 datë 14.10.2014.

Me vendim nr. 19 datë 04.11.2014 të KA miratohet riallokimi i fondit prej 7,000,000 lekësh si më poshtë:

- 4,813,000 lekë pakësohen shpenzimet për paga në UAMD;
- 2,187,000 lekë pakësohen nga shpenzime për sigurime shoqërore në UAMD;
- 5,000,000 lekë shtohen në shpenzime për paga për FASTIP;
- 2,000,000 lekë për shpenzime për sigurime për shoqërore dhe shëndetësore për FASTIP;

Me shkresën nr. 29 datë 05.11.2014 i percillet MFE vendimi i KA me nr. 19 datë 04.11.2014.

Me shkresën nr. 15210/2 prot, datë 21.11.2014 të MFE i percillet UAMD autorizimi mbi shtesat dhe pakësimet e përcaktuara në vendimin nr. 19 datë 04.11.2014 të KA dhe miratohet limiti mujor për këtë alokim.

Për Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, për vitin 2014, fondi i planifikuar nga buxheti i shtetit, për financimin e aktivitetit financiar, është në vlerën 419,697,532 lekë i perbërë nga :

- 288,707,000 lekë granti financim i dhënë në formën e transfertës së pakushtëzuar,
- 35,500,000 lekë nga fonde buxhetore për bursa dhe
- 95,490,532 lekë fonde buxhetore për investime.

Plani buxhetor i rishikuar me 31.12.2014 paraqitet:

Në lekë

Art.	Emërtimi	Fondet e Buxhetit		Totali
		Tit09450, K1	Tit09450, K8	
231	Plani vjetor	95,490,532	-	95,490,532
600	Plani vjetor	-	252,520,000	252,520,000
601	Plani vjetor	-	30,000,000	30,000,000
602	Plani vjetor	-	6,187,000	6,187,000
606	Plani vjetor	35,500,000	-	35,500,000
TOTALI		130,990,532	288,707,000	419,697,532

Burimi: UAMD, përpunuar nga grupi i auditimit

Në krahasim me vitin e kaluar 2013 do vërejmë se janë planifikuar 98 milion lekë më pak dhe ky ndryshim i përket kryesisht zërit shpenzim për investime.

Për sa i përket detajimit dhe përdorimit të fondeve buxhetore rezultoi se:



KONTROLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

- Plani buxhetor në zërin “Shpenzime për paga” është 252,520,000 lekë ose 60.2 % e fondeve buxhetore vjetore
- ✓ në zërin “Shpenzime për kontribute për sigurime shoqërore” është 30,000 000 lekë ose 7.14 % e fondeve buxhetore.
 - ✓ në zërin “Shpenzime operative” është 6,187,000 lekë ose 1.5 % e fondeve buxhetore.
 - ✓ në zërin “Shpenzime për burs “ është 35,500,000 lekë ose 8.45 % e fondeve buxhetore.
 - ✓ në zërin “Investime me financim nga granti konkurues” është 60,000,000 lekë ose 14.3 % te planit buxhetor vjetor
 - ✓ në zërin “Shlyerje e detyrime te prapambetura” të celura në artikullin 231 “Investime” është 35,490,532 lekë ose 8.45 % të totalit të planit buxhetor.

Bazuar në treguesit vjetor rezulton se aktiviteti i UAMD është financuar në masën 53 % nga buxheti i shtetit dhe 47 % nga të ardhurat e Institucionit.

Tabela mbi realizimin e shpenzimeve Viti 2014:

Në lekë

Art	Emërtimi	SITUACIONI I SHPENZIMEVE DHJETOR 2014				Totali
		Fondet e Buxheti	Fonde nga të ardhura		Fondet e Buxheti	
		Tit09450, K1-k1	Tit09770, K6	Tit09450, K6	Tit09450, K8	
230	Plan	-	1,629	-	-	1,629
	Fakt	-	-	-	-	-
231	Plan	95,490,532	-	144,864,571	-	240,355,103
	Fakt	95,490,532	-	140,627,168	-	236,117,700
466	Plan	-	-	31,066,558	-	31,066,558
	Fakt	-	-	31,066,558	-	31,066,558
600	Plan	-	-	111,046,806	252,520,000	363,566,806
	Fakt	-	-	100,391,732	252,520,000	352,911,732
601	Plan	-	-	21,858,375	30,000,000	51,858,375
	Fakt	-	-	19,151,236	30,000,000	49,151,236
602	Plan	-	258,04	73,875,962	6,187,000	80,321,002
	Fakt	-	-	72,100,969	6,186,998	78,287,967
606	Plan	35,500,000	-	5,283,493	-	40,783,493
	Fakt	35,500,000	-	4,962,699	-	40,462,699
Totali	Plan	130,990,532	259,669	387,995,765	288,707,000	807,952,966
	Fakt	130,990,532	-	368,300,362	288,706,998	787,997,892

Burimi: UAMD, përpunuar nga grupi i auditimit

Realizimi i shpenzimeve të planifikuara me burim financimi nga buxheti i vitit 2014, është në masën 100 % e planit dhe konkretisht:

Realizimi financiar i shpenzimeve në zërin “Investime” paraqitet në vlerën prej 95,490,532 lekë ose 39.7 % e planit buxhetor vjetor të miratuar në këtë zë. Plani buxhetor i miratuar është i ndarë në “Plani i çelur për të financuar detyrimet e prapambetura nga viti 2013” në vlerën 35,490,532 dhe “Plani i çelur nga fondi i zhvillimit te rajoneve, për projekte te reja, për vitin 2014” në vlerën 60,000,000 lekë. Fondet e celura për financimin e detyrimeve të prapambetuar janë përdorur për



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

financimin e detyrimeve për likuidimin e plotë të kontratës me Objekt “Ndërtimi i godinës së parë të Kampusit të Ri”. Fondi i celur në vlerën 60,000,000 lekë është përdorur për financimin e ndërtimit të godinës së dytë të kampusit.

Nga të ardhurat e veta janë financuar për vitin 2014 Shpenzime për financimin e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara me burim financimi nga të ardhurat, gjatë periudhës janar-31 dhjetor 2014, janë në vlerën 140,627,168 lekë dhe zënë 38 % të ardhurave të veta të përdorura.

VITI 2015

Aktiviteti financiar (realizimi faktik), për periudhën 01 janar-31 dhjetor 2015, për Universitetin “Aleksandër Moisiu”, është në vlerën 877,053,823 lekë, financiar nga buxheti i shtetit në vlerën 590,350,765 lekë dhe nga të ardhurat e Institucionit në vlerën 286,703,058 lekë ose thënë ndryshe në masën **67.3 %** nga buxheti i shtetit dhe **32.7 %** nga të ardhurat e veta.

Granti i miratuar për vitin 2015 ishte 365,624,000 lekë dhe fondi i bursave ishte 23,230,000 lekë. Detajimi grantit të vitit 2015 u bë në zbatim të shkresës nr. 9662/3 datë 12.01.2015 të MAS dhe Vendimit nr 1 datë 05.01.2015 të Këshillit të Administrimit.

Me shkresën nr. 2 datë 06.01.2015 i përcillet MFE vendimi nr 1 datë 05.01.2015 i KAMD.

Me vendim nr 10 datë 22.05.2015 të KADM bëhet rialokim në vlerën 22,000,000 lekë nga art 600 në art. 601 kap.8.

Me shkresën 198 datë 02.02.2015 kërkohet rialokim i fondit prej 30,920,000 lekesh nga UAMD në FASTIP.

Për Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, për vitin 2015, fondi i planifikuar nga buxheti i shtetit, për financimin e aktivitetit financiar, është në vlerën 590,350,765 dhe është 170,653,233 lekë më shumë sesa fondet buxhetore të vitit 2014. Plani buxhetor i miratuar për vitin 2015 paraqitet si më poshtë:

- 334,704,000 lekë nga granti financim i dhënë në formën e transfertës së pakushtëzuar,
- 31,230,000 lekë nga fonde buxhetore për shpenzime për bursa,
- 52,157,918 lekë fonde për financimin e shpenzimeve operative,
- 132,723,371 lekë fonde buxhetore për likuidimin e detyrimeve të trashëguara për investime dhe
- 39,730,476 lekë, fonde buxhetore për financimin e investimeve në vazhdim.

Miratimi i përdorimit të ardhurve u miratua me vendim nr 2, datë 15.01.2015 të Këshillit të Administrimit.

Në lekë

SITUACION VJETOR I SHPENZIMEVE					JANAR - DHJETOR 2015	
Art	Emërtimi	(Gr. Tit. Kap.)	Fonde nga të ardhura	Tit09770, K6	Tit09450, K8	Totali
		Fondet e Buxheti				
		Tit09450, K1-k4	Tit09450, K6			
230	Plan	-	-	1,629	-	1,629



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

	Fakt	-	-	-	-	-
231	Plan	172,453,847	87,958,818	-	-	260,412,665
	Fakt	172,453,847	62,754,848	-	-	235,208,695
600	Plan	-	149,855,074	-	262,704,000	412,559,074
	Fakt	-	130,296,399	-	262,704,000	393,000,399
601	Plan	-	25,007,139	-	62,000,000	87,007,139
	Fakt	-	18,503,662	-	62,000,000	80,503,662
602	Plan	52,157,918	73,274,993	311,920	10,000,000	135,744,831
	Fakt	52,157,918	65,369,760	-	10,000,000	127,527,678
606	Plan	31,035,000	11,320,794	-	-	42,355,794
	Fakt	31,035,000	9,778,389	-	-	40,813,389
Totali	Plan	255,646,765	347,416,818	313,549	334,704,000	938,081,132
	Fakt	255,646,765	286,703,058	-	334,704,000	877,053,823

Burimi: UAMD, përpunuar nga grupi i auditimit

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimin për zbatimin e buxhetit për vitin 2015, Institucioni, të ardhurat e papërdorura të realizuara gjatë vitit 2015 trashëgohen në vitin buxhetor pasardhës. Të ardhura e trashëguara në vitin 2016 janë 61,027,308 lekë.

VITI 2016

Aktiviteti financiar (realizimi faktik), gjatë këtij viti buxhetor, paraqitet në vlerën 876,150,540 lekë, i financuar në vlerën 546,312,503 lekë nga buxheti i shtetit dhe 329,838,037 lekë nga të ardhurat e Institucionit dhe konkretisht në masën **62.4 %** nga buxheti i shtetit dhe **37.6 %** nga të ardhurat e veta.

Granti buxhetor për vitin 2016, është i detajuar në zbatim të vendimit nr. 2 datë 05.01.2016 të Këshillit të Administrimit dhe paraqitet si më poshtë vijon:

Plani vjetor buxhetor në zërin “Shpenzime për paga” është 361,883,400 lekë ose 84 % e grantit të miratuar.

Plani vjetor buxhetor në zërin “Shpenzime për kontribute për sigurime shoqërore” është 57,450,000 lekë ose 13.4 % e grantit.

Plani vjetor buxhetor në zërin “Shpenzime operative” është 10,000,000 lekë ose 2.3 % e grantit.

Buxheti vjetor (grant + të ardhura) është miratuar me vendimin nr. 6 datë 20.01.2016 të Senatit Akademik dhe nga Këshilli i Administrimit.

Me vendim nr. 40 datë 04.08.2016 të Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve është miratuar fondi prej 90,781,329 lekësh për ndërtimin e godinës nr. 2 të kampusit të UAMD.

Me vendim nr 17 dt 15.11.2016 miratohet detajimi i grantit shtesë prej 30,000,000 lekësh. Me shkresën nr. 11337 dt 10.11.2016 të MASR pakësohet fondi prej 4,500,000 lekësh në zërin shpenzime për bursa.

Me shkresën nr 14824/1 dt. 10.11.2016 miratohet fondi prej 2,149,791 lekesh për rimbursim tvsh për projekte të huaja.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

Për vitin 2016, plani buxhetor i rishikuar (grant + buxhet), për financimin e aktivitetit financiar të UAMD, paraqitet në vlerën 551,111,120 ose 39,239,644 lekë më pak sesa fondet buxhetore të akorduara për vitin 2015. Plan i buxhetor i miratuar për vitin 2016 paraqitet si më poshtë:

- ✓ 429,450,000 leke nga granti (financim i dhënë në formën e transfertës së pakushtëzuar), (në vitin 2015 ishte 334, 704, 000 lekë)
- ✓ 28,730,000 lekë fonde buxhetore për shpenzime për bursa (në vitin 2015 ishte 31,230,000 lekë)
- ✓ 2,149,791 lekë për rimbursim TVSH (në vitin 2015 ishte 0)
- ✓ 90,781,330 lekë fonde buxhetore për financimin e investimeve (në vitin 2015 ishte 172,453,847 lekë)

Në lekë

PLANI BUXHETOR I RISHIKUAR PER PERIUDHEN 01 JANAR -31 DHJETOR 2016				
Art	BUXHETI			
	Plani buxhetor me 01,01,2016	Ndryshime te planit buxhetor gjate vitit 2016 (Shtesa)	Ndryshime te planit buxhetor gjate vitit 2016 (Pakesime)	Plani buxhetor i rishikuar me 31,12,2016
600 (Shpenzime per paga)	336,000,000	26,000,000	116,600	361,883,400
601 (Shpenzime per sigurime shoqerore)	53,450,000	4,000,000		57,450,000
602 (Shpenzime per shpenzime operative)	10,000,000			10,000,000
606 (Shpenzime per bursa,)	36,230,000		7,500,000	28,730,000
606 (Shpenzime per ndihma)		116,600		116,600
231(Shpenzime per investime,aktive te trupezuara)	90,781,329			90,781,329
231(Shpenzime per rimbursim TVSH-je)	2,149,791			2,149,791
TO TALI	528,611,120	30,116,600	7,616,600	551,111,120

Burimi: UAMD, përpunuar nga grupi i auditimit

Në tabelën më sipër evidentohen ndryshimet përkatëse shtesa/pakësime sipas llogarive, ndërkohë që Investimet e vitit nuk rezultojnë me ndryshime.

Tabela mbi realizimin e shpenzimeve Viti 2016

Në lekë



KONTROLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

Art	Analiza	BUXHETI			TE ARDHURA		Totali vjetor
		Granti (Transferta si fonde te pakushtezuara nga buxheti i	Buxheti (fonde me destinacion bursa dhe investime nga buxheti i vitit)	Buxheti (fonde me destinacion per pagesen e TVSH per projektet TEMPUS)	Jashte limiti (Transferta e kushtezuar per financimin e aktivitetit)	Jashte limiti (Transferta e kushtezuar per financimin e kerkimit shkencor)	
	Grup, Tit, Kap,	11-0.9450-8	11-0.9450-1	11-0.9450-4	11-0.9450-6	11-0.9770-6	
600	PLAN	361,883,400			42,352,641	206,034	404,442,075
	FAKTI	361,883,400			39,078,334	206,034	401,167,768
601	PLAN	57,450,000			8,503,477		65,953,477
	FAKTI	57,450,000			3,602,562		61,052,562
602	PLAN	10,000,000			89,782,033	672	100,454,033
	FAKTI	10,000,000			83,205,578	672	93,877,578
606	PLAN	116,6	28,730,000		1,542,405		30,389,005
	FAKTI	116,6	24,809,761		1,265,800		26,192,161
230	PLAN				138	1,629	139,629
	FAKTI				138		138
231	PLAN		90,781,329	2,149,791	208,755,562		301,686,682
	FAKTI		90,781,328	1,271,414	201,669,729		293,722,471
TOTAL	PLAN	429,450,000	119,511,329	2,149,791	351,074,118	879,663	903,064,901
	FAKTI	429,450,000	115,591,089	1,271,414	328,960,003	878,034	876,150,540

Burimi: UAMD, përpunuar nga grupi i auditimit

Realizimi vjetor për vitin 2016 paraqitet në masën rreth 97% ku të ardhurat buxhetore janë shpenzuar në masën 99.1 % ndërsa financimi i brendshëm në masën 93.7%.

Sa i përket investimeve ato janë realizuar në masën 97.3% të planifikimit të tyre dhe zënë 33.5% të fondeve të përdorura.

VITI 2017

Granti i miratuar për vitin 2017 paraqitet në vlerën 543,160,000 (përfshirë këtu edhe fondin e bursave)

Senati Akademik me Vendim nr.1, datë 05.01.2017 ka bërë detajimin e transfertës së pakushtezuar për vitin 2017 dhe me shkresën nr. 2 prot, datë 05.01.2017 ia ka percjell Bordit të Administrimit, për shqyrtim dhe miratim.

Bordi i Administrimit me vendim nr.3, datë 09.01.2017, ka miratuar detajimin e transfertës së pakushtezuar të vitit 2017 si më poshtë:

- 396,930,000 lekë për shpenzime pagash
- 60,000,000 lekë për shpenzime për kontribute sigurime shoqërore dhe shëndetësore
- 20,000,000 lekë për shpenzime operative
- 30,000,000 lekë për FASTIP
- 36,230,000 lekë për bursa

Me shkresën nr. 5, datë 09.01.2017, UAMD i ka dërguar Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Arsimit Rinisë dhe Sportit Vendimin nr. 3 datë 09.01.2017 të Bordit të Administrimit “Për miratimin e detajimit të grantit të vitit 2017”.

Me shkresën nr. 23 prot, datë 11.01.2017 UAMD i është dërguar Ministrisë së Financave “Detajimi i limitit mujor për vitin 2017”



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

Ministria e Financave me shkresën nr. 17911/315 prot, datë 02.02.2017 ka dërguar miratimin e detajimit të grantit për vitin 2017 dhe me shkresën nr.17911/332, datë 07.02.2017 ka dërguar edhe miratimin e limitit mujor, për vitin 2017.

Me shkresën nr. 10240/1 prot, datë 03.08.2017 Ministria e Financave ka dërguar një shtesë të fondit të pagave për efektet e rritjes së pagave 2017. Fondi shtesë i akorduar për UAMD është 24,539,776 lekë.

Në zbatim të vendimit nr. 19, datë 02.10.2017 të Bordit të Administrimit është detajuar edhe granti shtesë, ardhur nga MASR më 04.09.2017, në vlerën 24,539,776 lekë, si më poshtë:

- 11,539,776 lekë shpenzime për paga
- 10,000,000 lekë shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore
- 1,000,000 lekë për shpenzime për paga FASTIP
- 2,000,000 lekë për shpenzime operative fastip.

Me shkresën nr. 919 prot, datë 03.10.2017, UAMD i ka percjell Ministrisë së Financave dhe MASR detajimin e grantit shtesë për vitin 2017.

Ministria e Financave me shkresën nr.13572/2 prot, datë 20.10.2017 i percjell UAMD –së miratimin e detajimit të grantit shtesë dhe limitet mujore për këtë fond shtesë.

Sa më sipër rezulton se, nga granti i miratuar për vitin 2017, për UAMD, 33,000,000 lekë iu transferuan FASTIP-it dhe buxheti i UAMD rezulton në vlerën 534,699,776 lekë.

Nga fondi i miratuar për UAMD, për vitin 2017 u miratua shpërblimi në masën 94,000 lekë. Për këtë arsye rezulton alokimi nga kap.8, artikulli 600 në kap.8, artikullin 606. Ky veprim nuk sjell rezultat në fondin buxhetor vjetor për UAMD.

Në nëntor të vitit 2017 nga MASR u miratua fondi buxhetor prej 40,000,000 lekësh në zërin “shpenzime për investime” me destinacion për financimin e projektit për ndërtimin e godinës nr.2 të Kampusit Universitar, Durrës.

Më 15.11.2017, me vendim nr. 28, datë të Bordit të Administrimit u bë alokimi prej 4,000,000 lekësh nga kap.8 art. 600 në kap.8 art. 601.

Duke marrë në konsideratë vendimet e sipërcituara dhe të ardhurat e trashëguara me 01.01.2017, plani buxhetor dhe plani i të ardhurave për periudhën janar – 31 dhjetor 2017 paraqitet sipas tabelës më poshtë:

Në lekë

Emërtimi	BUXHETI	TE ARDHURA		
Art	Plani buxhetor i rishikuar me 31.12.2017	Të ardhura të trashëguara me 01.01.2017	Të ardhura të miratuara për vitin 2017, sipas vendimit nr 10. Dt. 25.05.2017	TOTALI I MIRATUAR
600 (Shpenzime për paga)	412,375,776	3,274,307	60, 000 000	475,650,083
601 (Shpenzime për sig.shoqërore)	66,000,000	4,900,915	5, 000 000	75, 00,915
602 (Shpenzime operative)	20,000,000	6,576,455	100, 000 000	126,576,455
606 (Shpenzime për bursa,)	36,230, 000			36,230,000
606 (Shpenzime për ndihma)	94,000	276,605		370,605
231 (Shpenzime për investime)	40,000,000	7,087,461		47,087,461
TOTALI	574,699,776	22,115,744	165,000,000	761,815,520

Burimi: UAMD, përpunuar nga grupi i auditimit



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

Aktiviteti financiar (realizimi faktik), për periudhën 01 janar-31 dhjetor 2017, paraqitet në vlerën 835,496,694 lekë, i financuar në vlerën 557,818,711 lekë nga buxheti i shtetit për vitin 2017 dhe 277,677,983 lekë nga të ardhurat e Institucionit ose në masën 67% nga buxheti i shtetit dhe 33% nga të ardhurat e Institucionit. Në tabelën më poshtë paraqitet realizimi i shpenzimeve për këtë periudhë buxhetore.

Në lekë

Art.	Emërtimi	Fondet e Buxheti	Granti	Te ardhura	TOTALI
		Tit09450, K1	Tit09450, K8	Tit09450, K6	
230/ 231 shpenzime per investime	Plan	40,000,000	-	115,387,462	155,387,462
	Fakt	40,000,000		90,202,978	130,202,978
600 shpenzime per paga	Plan	-	412,375,776	101,375,222	513,750,998
	Fakt	-	412,375,776	90,151,820	502,527,596
601 shpenzime per sigurime shoqerore	Plan	-	66,000,000	6,300,000	72,300,000
	Fakt	-	66,000,000	6,076,063	72,076,063
602 shpenzime operative	Plan		20,000,000	100,428,563	120,428,563
	Fakt		19,984,578	87,264,122	107,248,700
606 shpenzime per bursa dhe transferta	Plan	36,141,000	94,000	4,065,492	40,300 492
	Fakt	19,364,357	94,000	3,983,000	23,441,357
TOTALI VJETOR	Plan	76,141 000	498,469,776	327,556,739	902,167,515
	Fakt	59,364,357	498,454,354	277,677,983	835,496,694

Burimi: UAMD, përpunuar nga grupi i auditimit

Sa i përket investimeve, fondi i parashikuar prej 40,000,000 lekë u miratua nga buxheti i shtetit për financimin e projektit “Ndërtimi i godinës nr. 2 të Kampusit Universitar”.

Për sa i përket investimeve të realizuara nga të ardhurat e UAMD rezultoi si më poshtë vijon:

- 60,000,000 lekë u financua projekti për “Ndërtimin e godinës nr.2 në kampus” (projekt ky i miratuar në vitin 2013 me bashkëfinancim të UAMD dhe FZHR)
- 20,000,000 lekë u financua projekti “Blerje orendi shkollore” në vlerën (projekt i miratuar në vitin 2014 me financim nga të ardhurat e UAMD)
- 5,898,862 lekë u financua projekti “Vendosja e sistemit kundra zjarrit” (projekt i nisur në vitin 2016 me financim nga të ardhurat e UAMD)
- 1,629,626 lekë u shpenzuan për blerje pajisje në kuadër të bashkëfinancimit dhe pjesëmarrjes në projektet TEMPUS dhe DAEWWEB të miratuara në vitin 2016,
- 674,400 lekë blerje u shpenzuan për “Blerje tabela dhe stenda orientuese” kontratë e lidhur në vitin 2016 me financim nga të ardhurat e UAMD.

Të ardhurat e autorizuar për investime janë përdorur për likuidimin e detyrimeve të trashëguara për kontrata të lidhura në vitin 2013 dhe 2014 dhe 2015, si detyrime në vijim dhe në zbatim të kontratave. Në vitin 2017 nuk është financuar dhe nuk janë lidhur kontrata për investime të reja. Realizimi i shpenzimeve për investimeve, për vitin 2017 lidhen me financimin e projekteve të miratuara dhe që kanë filluar të realizohen para vitit 2017.

Referuar të dhënave të mësipërme financimi i investimeve për vitin 2017 është bërë në masën 31 % nga buxheti i shtetit dhe 69 % nga të ardhurat e Institucionit.

Peshën më të madhe në shpenzimet për investime e zënë shpenzimet për ndërtimin e godinës së dytë në tuallin e Kampusit të Ri Universitar (Projekt që ka filluar të realizohet në vitin 2013). Ky



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

projekt, për vitin 2017 është financuar në vlerën 102,000,000 lekë (40,000,000 lekë nga buxheti i shtetit dhe 62,000,000 lekë nga të ardhurat e Institucionit. (Ky investim zë 78.3 % të totalit të shpenzimeve për investime).

VITI 2018

Projekt Buxhetit Afatmesëm 2018 – 2020 është hartuar në mbështetje dhe në zbatim të:

- Ligjit nr. 109/2016 date 15.12.2016 “Për buxhetin e vitit 2017”.
- Udhëzimit nr. 23 datë 22.11.2016 “Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2018-2020, të Ministrit të Financave.
- Shkresës nr. 6905 PROT, datë 11.07.2017 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm (PBA) 2018-2020” të Sekretarit të Përgjithshëm të MAS.
- Formularëve standard të Aneksit 7 A. PBA 2018-2020 dërguar nga MAS sipas shkresës së sipërcituar.
- Udhëzimin nr. 10 datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020”, të Ministrisë së Financave.
- Udhëzimit “Për përgatitjen e Projekt Buxhetit Afatmesëm për UAMD”, miratuar nga Rektorati i Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, në datë 05.01.2010.
- Shkresës nr.635 prot, datë 27.06.2017 të Kancelarit “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për periudhën 2018-2020”, drejtuar dekanëve të Fakulteteve.
- Shkresës nr. 635/1 prot, datë 17.07.2017 “Programi Buxhetor Afatmesëm, për periudhën 2018-2020” të Dekanit të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, shkresës nr. 635/2 prot datë 17.07.2017 “Kthim përgjigje shkresës me Nr.635 Prot datë 27.06.2017” të Dekanes së Fakultetit të Biznesit, shkresës nr.635/3 prot, datë 17.07.2017 “Përgjigje suajës nr.635 prot, datë 27.06.2017 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm, për periudhën 2018-2020” të Dekanit të Fakultetit të Edukimit, shkresës nr. 2103 prot, datë 19.07.2017 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm, për periudhën 2018-2020 paraqitur nga Fakulteti i Studimeve Profesionale”, të Dekanit të Fakultetit të Studimeve Profesionale, shkresës nr.635/4 datë 20.07.2017 “Përcjellja e Projekt Buxhetit Afatmesëm, për periudhën 2018-2020” të Dekanit të Fakultetit të Shkencave Politike dhe Juridike.

Shpenzimet Funksionale në PBA 2018-2020

Totali i shpenzimeve të paraqitura në Projekt Buxhetin Afatmesëm (2018 -2020), për vitin 2018, për Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, paraqitet me një vlerë prej 1,375,333 000 lekë, nga të cilat lekë 969,961,000 lekë (ose 70 %) të financuara nga buxheti i shtetit dhe 405,372,000 lekë (ose 30%) të financuara nga të ardhurat e veta.

Në krahasim me shpenzimet funksionale të pritshme për vitin 2017 në PBA 2018-2020 ka patur një rritje 489,058,000 lekë ose 55 % më shumë se niveli i shpenzimeve të pritshme për vitin 2017. Kjo pasqyrohet kryesisht në rritjen e shpenzimeve të financuara nga buxheti i shtetit.

Kjo me arsyetimin si më lartë dhe duke planifikuar që shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore të përballohen në masën 100 % nga buxheti.

Totali i shpenzimeve për funksionim (paga + sigurime+shpenzime operative, duke përfshirë edhe shpenzime operative për kërkimin shkencor) është në vlerën 1,068,115,000lekë ose 77.6 % e



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

plan buxhetit. Këto shpenzime janë planifikuar të financohen në vlerën 769,961,000 lekë ose 72% nga buxheti i shtetit dhe 298,154,000 lekë ose 28% nga të ardhurat.

Zbatimi i Buxhetit të miratuar

Edhe për vitin 2018 financimi i aktivitetit ekonomiko-financiar i UAMD është realizuar nga buxheti i shtetit (granti i mësimdhënies akorduar në formën e transfertës së pakushtëzuar+ të ardhurat e veta si dhe fondi buxhetor i miratuar për shpenzime për investime.

Granti i miratuar nga MASR për Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës ishte në vlerën 508,824,000 lekë.

Në zbatim të Vendimit nr. 75, datë 12.02.2018 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor” pika 1, fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për UAMD i shpërndarë në formën e grantit të mësimdhënies cili u detajuar në:

- a) fondin për funksionimin e institucionit, në masën jo më pak se 90%;
- b) fondin e mbështetjes studentore, në masën deri në 10% në vit.

Në zbatim të nenit 38 “Funksionet e Senatit Akademik”, gërma h) dhe nenit 49 të ligjit, nr. 80/2015, datë 22.07.2015 ”Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, detajimi i transfertës së pakushtëzuar për vitin 2018, u bë sipas propozimit të Senatit Akademik i cili do t’i përcillet për miratim në Bordit të Administrimit.

Sa më sipër granti i mësimdhënies (transferta e pakushtëzuar) e vitit 2019, u detajua në shpenzime për paga, shpenzime për sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe shpenzime për bursa sipas vendimit nr 1, datë 04.01.2018 të Senatit Akademik “Për miratimin paraprak të detajimit të transfertës së pakushtëzuar për vitin 2018” për Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës. Ky vendim i është përcjell për miratim Bordit të Administrimit i cili me vendim nr. 1, datë 08.01.2018 ka miratuar detajimin e grantit për vitin 2018 si më poshtë”

- 407,824,000 lekë shpenzime për paga
- 60,000,000 lekë për shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore
- 21,000,000 lekë për shpenzime operative
- 20,000,000 lekë për bursa

Me shkresën nr. 10 prot, datë 08.02.2018 i përcillet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë vendimi nr. 1, datë 08.01.2018 i Bordit të Administrimit “Për miratimin e detajimit të grantit të vitit 2018”.

Me shkresën nr. 19 prot., datë 09.01.2018 me objekt “Dërgohet detajimi mujor i buxhetit të vitit 2018” përcillet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë detajimi mujor (limitet) mujore, për vitin 2018.

Me shkresën nr. 13287/2, datë 11.01.2018 të MASR i përcjell Universtetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës buxhetin e miratuar për vitin 2018 si dhe limitet mujore.

Detajimi i grantit të vitit 2018 është bërë në konsideratë planifikimin e bërë në PBA 2019-2021, numrin e punonjësve, numrin e studenteve të cilët vijojnë studimet për vitin akademik 2018 - 2019, shpenzimet e nevojshme për një funksionim normal të procesit mësimor. Nga granti i



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

miratuar 96% e fondit (pa përfshirë fondin për bursa) është planifikuar për shpenzime personeli (paga + sigurime shoqërore) dhe 4 % për shpenzime për operative mujore të domosdoshme për funksionimin normal (psh shpenzime për energji, uje, shërbim postar etj.)

Me vendimin nr. 5, datë 25.01.2018, Bordi i Administrimit miraton ”Planin buxhetor (grant+të ardhura për vitin 2018”, për Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës.

Me vendimin nr. 6, datë 25.01.2018 Bordi i Administrimit miraton përdorimin e të ardhurave, për financimin e aktivitetit ekonomiko- financiar, të vitit 2018, për Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës.

Me shkresën nr. 391/1, datë 14.02.2018 me objekt ”Dërgohet detajimi i grantit për vitin 2018” Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë i përcjell Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës miratimin e detajimit mujor të grantit 2018.

Me shkresën nr. 394/2, datë 19.02.2018 me objekt “Miratim limiti”, Ministria e Financave ka përcjell miratimin e detajimit të buxhetit (grantit), dhe limitet për vitin 2018.

Me shkresën nr. 1417/1, datë 15.02.2018 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë me objekt “Dërgohet buxheti i miratuar, për shpenzimet kapitale, për vitin 2018”, janë miratuar fondet për shpenzime kapitale për Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës.

Me vendim nr. 50, datë 18.07.2018 Bordi i Administrimit ka miratuar transferimin e fondit prej 11,000,000 lekesh nga art. 601 në art. 606.

Me shkresën nr. 1150 prot, datë 19.07.2018 Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës i përcjell Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë vendimin nr. 50 datë 18.07.2018 të Bordit të Administrimit.

Me shkresën nr. 13997/1, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, datë 26.07.2018 me objekt “Transferim granti për vitin 2018”, është miratuar transferimi i grantit nga art. 601 në art. 606 në vlerën 11,000,000 lekë.

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë me shkresën nr.1417/1, datë 15.02.2018 me objekt “Dërgohet buxheti i miratuar, për shpenzimet kapitale, për vitin 2018”, ka miratuar fondin prej 50,000,000 lekësh për shpenzime kapitale për Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës për financimin e punimeve ndërtimore për godinën nr. 2 të Kampusit të ri Universitar në UAMD.

Bordi i Administrimit me vendim nr. 85, datë 28.12.2018 ka bërë alokimin e fondit prej 30,000,000 lekësh nga art. 231 (shpenzime për investime nga të ardhurat e veta) në shpenzime për paga në vlerën 15,000, 000 lekë dhe shpenzime për sigurime shoqërore në vlerën prej 14,000,000 lekë si dhe shpenzime për projekte në vlerën 1,000,000 lekë.

Në zbatim të vendimeve të sipërpërmendura, alokimeve të miratuara gjatë vitit, të ardhurat e trashëguara dhe të ardhurat e miratuara për vitin 2018, plani buxhetor dhe plani i buxhetit të miratuar (grant + të ardhura) i miratuara për periudhën janar – 31 dhjetor 2018 paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Në lekë

Emertimi	BUXHETI	TE ARDHURA
----------	---------	------------



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

Art	Plani buxhetor i rishikuar me 31.12.2018	Te ardhura te miratuara per tu perdorur (plani i rishikuar 31.12.2018	Te ardhura te miratuara per vitin 2018, per financimin e projekteve	TOTALI I MIRATUAR
600 (Shpenzime per paga)	396,824,000	137,000,000		533,824,000
601 (Shpenzime per sigurime shoqerore)	60,000,000	24,000,000		84,000,000
602 (Shpenzime per shpenzime operative)	21,000,000	95,440,000	6,341,669	122,781,669
606 (Shpenzime per bursa,)	31,000,000			31,000,000
606 (Shpenzime per ndihma)				0
230 (Shpenzime per investime)		1,000,000		1,000,000
231 (Shpenzime per investime)	50,000,000	115,000,000	7,677,946	172,677,946
TOTALI	558,824,000	372,440,000	14,019,615	945,283,615

Burimi: UAMD, përpunuar nga grupi i auditimit

Për sa i përket financimit të aktivitetit ekonomiko-financiar nga të ardhurat e vet institucionit, sqarojmë se në çelje të vitit 2018 institucioni ka trashëguar fonde të papërdorura në vitin paraardhës 2017 në vlerën prej 49,878,756 lekë.

Aktiviteti financiar (realizimi faktik), për periudhën buxhetore viti 2018, paraqitet në vlerën 896,719,320 lekë. Veprimtaria financiare e vitit 2018 është financuar në vlerën 558,820,161 leke nga buxheti i shtetit për vitin 2018 dhe 337,899,159 lekë nga të ardhurat e veta. Sa më sipër rezulton se aktiviteti financiar është financuar në masën **62.3 %** nga buxheti i shtetit dhe **37.7 %** nga të ardhurat e Institucionit. Rritja e shpenzimeve për vitin 2018 krahasuar me vitin 2017 është reflektuar në rritjen e shpenzimeve të financuara nga të ardhurat e veta. Shpenzimet e financuara nga buxheti i shtetit për vitin 2018 paraqiten thuajse në të njëjtin nivel me ato të vitit 2017.

Në lekë

Art	Emërtesa	Analiza	(Gr. Tit. Kap.)				Totali
			Fondet e Buxheti	Fonde nga të ardhura		Fonde nga granti	
			Tit09450, K1-k1	Tit09770, K6	Tit09450, K6	Tit09450, K8	
230	Shpenzim per hartim projekte ndertimore	Plan			761,629		761,629
		Fakt			752,699		752,699
231	Shpenzime per investime te trupezuara	Plan	50,000,000		106,452,855		156,452,855
		Fakt	50,000,000		103,025,734		153,025,734
466	Clirim garancie	Plan			521,693		521,693
		Fakt			521,693		521,693
600	Shpenzime per paga	Plan			133,692,215	396,686,480	530,378,695
		Fakt			129,754,362	396,682,641	526,437,003
601	Shpenzime per sigurime shoqerore	Plan			22,242,845	60,000,000	82,242,845
		Fakt			20,804,584	60,000,000	80,804,584
602	Shpenzime operative	Plan		725,984	78,796,085	21,000,000	100,522,069
		Fakt		724,296	71,922,988	21,000,000	93,647,284
606	Shpenzime per bursa dhe ndihma te tjera	Plan			11,111,256	31,137,520	42,248,776
		Fakt			10,392,803	31,137,520	41,530,323
TOTALI VJETOR		Plan	50,000,000	725,984	353,578,578	508,824,000	913,128,562
		Fakt	50,000,000	724,296	337,174,863	508,820,161	896,719,320

Burimi: UAMD, përpunuar nga grupi i auditimit


Grafikisht situata paraqitet si më poshtë:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

Realizimi faktik i shpenzimeve viti 2018



“**Shpenzime për paga**”, (Art 600) si paraqitet edhe në tabelë peshën kryesore në shpenzimet vjetore në vlerën 526,437,003 lekë ose **58.7 %** të totalit të shpenzimeve faktike vjetore 2018. Ato janë financuar në vlerën 396,682,641 lekë ose 75 % nga buxheti dhe 25 % nga të ardhurat e UAMD. Financimi i shpenzimeve për paga nga granti paraqitet 15,693,135 lekë më pak sesa viti 2017. Peshën kryesore në vlerën 453,525,280 lekë ose masën 86 % të shpenzimeve totale për paga e zënë shpenzimet për pagat e personelit me kohë të plotë. Shpenzimet për paga të financuara nga të ardhurat janë në vlerën 129,754,362 lekë, pra 38.4% e të ardhurave vjetore janë përdorur për financimin e shpenzimeve për paga ku përfshihen, shpenzimet për pagesën e orëve mësimore të realizuara mbi mësimdhënien e normuar vjetore, shpenzimet për personelin akademik me kohë të pjesshme dhe punonjës mbështetës.

“**Shpenzime operative**” (Art.602) Realizimi faktik, paraqiten në vlerën 93,647,284 dhe zënë rreth 10.4% të totalit të shpenzimeve faktike vjetore. Gjatë vitit 2018 është mbështetur financiarisht nga të ardhurat e Insitucionit edhe realizimi i aktiviteteve shkencore dhe projektet kerkimore shkencore për të cilat janë shpenzuar 7,246,149 lekenga cilat 674, 222 lekë janë pasqyruar ne prog 09770.

“**Bursa dhe transferta të tjera**” (Art. 606) Realizimi faktik, paraqitet në vlerën 41,530,323 lekë dhe zënë 4.6 % në totalin e shpenzimeve faktike vjetore. Në krahasim me vitin 2017 shpenzimet në këtë zë paraqiten më të rritura në vlerën 18,088,966 lekë pasi në vitin akademik 2017-2018 janë trajtuar me bursë 690 studentë ose 141 studentë më shumë sesa viti akademik 2016-2017.

“**Shpenzime për rritjen e aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara**” (Art 230 dhe 231) janë në vlerën 153,778,433 ose 17 % të totalit të shpenzimeve vjetore. Për vitin 2018 financimi në këtë zë vjen në vlerën 50,000,000 lekë ose 32.5 % nga buxheti i shtetit dhe 103,778,433 lekë nga të ardhurat e UAMD. Fondi prej 50,000,000 lekësh i akorduar në këtë zë është akorduar për financimin e punimeve ndërtimore për Godinën nr. 2 të Kampusit Universitar. Pra në shpenzimet për investime mbizotërojnë të ardhurat e veta.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

Për sa i përket shpenzimeve për investimeve të realizuara nga të ardhurat ato janë fokusuar kryesisht në likuidimin e detyrimeve të trashëguara nga viti 2017 si dhe financimin e punimeve ndërtimore duke i dhënë prioritet përmirësimit në infrastrukturë dhe blerje orendish dhe pajisjesh për procesin mësimor dhe atë administrativ. Të ardhurat e autorizuara për investime janë përdorur në vlerën 69,168,017 lekë për likuidimin e detyrimeve të trashëguara dhe pjesa tjetër për detyrime në zbatim të kontratave në vijim.

Per periudhën janar-31 dhjetor 2018 janë arkëtuar 303,944,066 lekë të cilat detajohen në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Nr.	Emërtimi	Vlera e arkëtuar
1	Tarifa Shkollimi	285,064,286
2	Tarifa Regjistrimi	6,326,945
3	Të tjera	12,552,835
Shuma gjithsej		303,944,066

Burimi: UAMD, përpunuar nga grupi i auditimit

Sa më sipër, 94 % e të ardhurave që arkëtohen i përkasin tarifave të shkollimit. Gjatë këtij viti buxhetor janë arkëtuar 1,522,397 lekë më pak sesa viti 2017. Ulja e të ardhurave vjen në zërin “tarifa shkollimi”. Përdorimi i të ardhurave të veta përfshirë fondin e trashëguar nga viti paraardhës është përdorur si më poshtë.

Në lekë

EMERTIMI	VITI 2018	
	Në lekë	Në %
Shpenzime per paga	129,754,362	38%
Shpenzime per sigurime shoqerore	20,804,584	6%
Shpenzime operative	72,647,284	22%
Shpenzime per rimbursim individesh	10,392,803	3%
Per Investime	103,778,433	31%
TOTALI	337,377,466	100%

Burimi: UAMD, përpunuar nga grupi i auditimit

VITI 2019

Projekt Buxhetit Afatmesëm 2019 – 2021 është hartuar në mbështetje dhe në zbatim të:

-Shkresës prot.nr. 1153/1, 1153/2 dhe 1153/3 datë 19.07.2018 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm, për periudhën 2019-2021”, të Administratorit drejtuar Njësive Kryesore;
 -Shkresës prot.nr., 1080 datë 27.07.2018 “Përcillen të dhënat statistikore dhe kërkesat për blerje materiale për Drejtorinë e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike në kuadër të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021”, të Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

- Shkresës nr.1080/3 prot, datë 27.07.2018 “Kthim përgjigje mbi shkresën nr. 1153/5 prot, datë 19.07.2018 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për periudhën 2019-2021”, të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Juridike;
- Shkresës nr.1080/4 prot, datë 27.07.2018 “Përgjigje e kërkesës të datës 19.07.2018 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm, për periudhën 2019-2021”, të Këshillit të Kërkimit Shkencor;
- Propozimeve të përcjella me shkresat përkatëse të Fakulteti i Biznesit, Fakulteti i Edukimit, Fakulteti i Studimeve Profesionale, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit dhe Fakulteti i Shkencave Politike dhe Juridike për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm, për periudhën 2019-2021;
- Vendimit nr. 135, datë 27.08.2018 të Senatit Akademik;
- Vendimit nr. 61, datë 28.08.2018 të Bordit të Administrimit;

Hartimi i Shpenzimeve Funksionale të PBA vitet 2019-2021

Totali i shpenzimeve të paraqitura në Projekt Buxhetin Afatmesëm (2019-2021), për vitin 2019, për Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, paraqitet me një vlerë prej 1,332,415,000 lekë, nga të cilat 932,099,000 lekë (ose 70 %) të financuara nga buxheti i shtetit dhe 400,316,000 lekë (ose 30%) të financuara nga të ardhurat e veta.

Kërkesa e paraqitur për vitin 2019 është paraqitur në dy programe. Programi 09450 (programi i shpenzimeve për funksionimin) dhe programi 09970 “shpenzime për kërkimin shkencor”.

Kërkesa totale në programin 09450 është në vlerën prej 1,273,916,000 lekesh dhe kërkesa në programin 09970 është në vlerën prej 58,499,000 lekë.

Kërkesa e paraqitur në këtë projekt buxhet vjen me 228,823,000 leke më e rritur sesa shpenzimet faktike të vitit 2017 ose 400,151,000 lekë më shumë sesa shpenzimet e pritshme të vitit 2018. Kjo arsyetohet me faktin se në vitin akademik 2018-2019 numri i studentëve parashikohet të ketë një rritje prej 2,180 studentë më shumë si rrjedhojë e shtimit të kuotave të reja pasi synojmë hapjen e programeve të reja në të treja ciklet e studimit dhe rritjen e kërkesës për kuota në programet e ofruara aktualisht.

Kërkesa e rritur për buxhet për vitin 2019 pasqyrohet kryesisht në rritjen e shpenzimeve të financuara nga buxheti i shtetit në zërin “shpenzime për funksionimin”. Në këtë zë përfshihen shpenzime për personelin me kohë të plotë, shpenzime operative dhe shpenzime për bursa. Shpenzimet për personelin, të financuara nga buxheti i vitit 2019, parashikohen në vlerën 653,557,000 lekë dhe zënë 85 % të shpenzimeve buxhetore për funksionimin. Ky zë paraqitet 196,733,000 lekë më shumë sesa i pritshmi i vitit 2018 pasi në vitin 2019 planifikohet që 100% të shpenzimeve për personelin me kohë të plotë të financohen nga buxheti duke i lënë vend kështu përdorimit të të ardhurave për financimin e investimeve.

Aktiviteti ekonomik-financiar për vitin 2019 është financiar nga buxheti i shtetit (në formën e grantit) dhe nga të ardhurat e vet Institucionit. Detajimi dhe përdorimi i buxhetit për këtë vit buxhetor është bërë në mbështetje të ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015, VKM nr. 75, datë 12.2.2018 “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, Udhëzimit të MFE “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2019”.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

Granti i mësimdhënies i akorduar për Universitetin ‘Aeksandër Mosiu’, Durrës më datë 05.01.2019 ishte në vlerën 558,711,348, përfshirë këtu edhe fondin e bursave. Aktiviteti financiar është zhvilluar në dy programe buxhetore në programin 09450 (programi për funksionimin) dhe programin 09770 (program për kërkimin shkencor).

Senati Akademik me vendim nr.1 datë 09.01.2019 ka bërë propozimin mbi detajimin e Grantit të vitit 2019.

Bordi i Administrimit me Vendim nr.1, datë 09.01.2019 ka miratuar detajimin e grantit 2019 si më poshtë:

- 423,171,572 lekë për shpenzime për paga
- 80,000,000 lekë për shpenzime për sigurime shoqërore
- 21,000,000 lekë për shpenzime operative
- 34,539,776 lekë për shpenzime për bursa.

Me shkresën nr. 29, datë 09.01.2020 UAMD i përcjell Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Vendimin nr.1 të Bordit të Administrimit “Për detajimin e grantit të vitit 2019”.

Senatit Akademik me vendim 11, datë 14.02.2019 miraton buxhetin e vitit 2019 (buxhet + të ardhura) dhe ia përcjell për miratim përfundimtar Bordit të Administrimit.

Bordi i Administrimit me Vendim nr. 8 datë 19.02.2019 miraton buxhetin e vitit 2019 sipas tabelës së mëposhtme:

Në lekë

Llog.	Lloji i shpenzimit	Financimi nga granti	Financimi nga të ardhurat + grant per rimbursim		Gjithsej
		Gr.11, Prog 09450, kap 8	Gr.11, Prog 09450, kap 6 dhe 8	Gr.11, Prog 09770, kap 6	
600	Shpenzime per paga	423,171,572	111,000,000		534,171,572
601	Shpenzime per sigurime shoqerore	80,000,000	20,740,237		100,740,237
602	Shpenzime operative	21,000,000	65,000,000	11,500,000	97,500,000
606	Shpenzime per bursa dhe transferta te tjera per studente	34,539,776	105,000,000		139,539,776
230	Shpenzime per investime (te patrupezuara)				
231	Shpenzime per investime (te trupezuara)		83,734,170		83,734,170
Totali		558,711,348	385,474,407	11,500,000	955,685,755

Burimi: UAMD, përpunuar nga grupi i auditimit

Bordi Administrimit me vendim nr. 9, datë 19.02.2019, miraton përdorimin e të ardhurave të pritshme të vitit 2019, sipas tabelës së mëposhtme:



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

NR.	EMERTIMI	TE ARDHURA TE PRITSHME PER TUPERDORUR GJATE VITIT 2019 (NE LEKE)	PERDORMINE % NDAJ TOTALIT TE TE ARDHURAVE TE PRITSHME PER TU PERDORUR
II	TE ARDHURA TE PRITSHME PER VITIN 2019	396,974,407	
	Nga te cilat:		
I.1	Financimi i pritshem nga MASR ne zbatim te Vendimeve te Keshillit te Ministrave te dates 26.12.2018 , te ndryshuar	180,595,000	
I.2	Te ardhura te pritshme nga te ardhurat tona	216,379,407	
	TOTALI I TE ARDHURAVE TE TE PRITSHME PER TU PERDORUR	396,974,407	100%
	Nga te cilat:		
A	TE ARDHURAT TE CILAT DO TE PERDOREN PER TE FINACUAR SHPENZIMET PER PERSONELIN (art. 600)	111,000,000	28%
a.1	Te ardhura per cilat do te perdoren per te financuar shpenzimet per personelin me kohe te plote	81,000,000	
a.3	Te ardhura te cilat do te perdoren per te financuar shpenzimet per personelin akademik me kohe te pjesshme	30,000,000	
B	TE ardhura te cilat do te perdoren per te financuar shpenzimet per te paguar detyrimet per sigurime shoqerore dhe shendetsore per stafin me kohe te pjesshme, te pagueshme nga punedhenesi (Art. 601)	20,740,237	5%
C	TE ARDHURAT TE CILAT DO TE PERDOREN PER TE FINACUAR SHPENZIMET OPERATIVE (art. 602)	65,000,000	16%
c.1	Te ardhurat te cilat do te perdoren per te financuar shpenzime operative te domosdoshme per funksionimin (energji + uje + posta+ regjistrim programesh, udhetime brenda vendit, pjesmarrje ne komisione etj)	10,000,000	
c.2	Te ardhurat te cilat do te perdoren per te financuar shpenzime operative (detyrime nga viti 2018 + shpenzime te vitit 2019)	55,000,000	
D	TE ARDHURAT TE CILAT DO TE PERDOREN PER TE FINACUAR KERKIMIN SHKENCOR (art. 602), prog 09770	11,500,000	3%
d.1	Te ardhurat te cilat do te perdoren per te financuar aktivitetet shkencore, per vitin 2019	6,500,000	
d.2	Te ardhurat te cilat do te perdoren per te financuar projektet kerkimore, per vitin 2019	5,000,000	
E	TE ARDHURAT TE CILAT DO TE PERDOREN PER TRAJTIMIN E STUDENTEVE (ART.606)	105,000,000	26%
e.1	TE ARDHURAT TE CILAT DO TE PERDOREN PER TE RIMBURSUAR STUDENTET (ART 606) SIPAS VKM - ve TE DATES 26.12.2018	105,000,000	
F	TE ARDHURAT TE CILAT DO TE PERDOREN PER TE FINACUAR SHPENZIMET PER INVESTIME TE TRUPEZUARA (art. 231)	83,734,170	21%
f.1	Te ardhura te cilat do te perdoren per te likujduar shpenzime per investime (per	83.734.170	

Në zbatim të akteve nënligjore të miratuara në kuadër të “Paktit për universitetin” 105,000,000 lekë janë miratuar për trajtimin financiar dhe mbështetjen e studentëve.

Në zbatim të VKM nr.778, datë 26.12.2018, tarifa e shkollimit për studentët e ciklit të parë të studimit u pagua në masën 50%. Gjithashtu në zbatim të VKM nr. 779 dhe 780, datë 26.12.2018 u shtua numri i kategorive të studentëve të ciklit do të përjashtohen në masën 100% nga detyrimi për të paguar tarifën e shkollimit dhe numri i kategorive të studentëve të ciklit të dytë të cilët do të paguanin 50% të tarifës së shkollimit.

Në këtë kontekst, Bordi i Adminstrimit me vendim nr.3, datë 14.01.2019 vendosi rimbursimin e tarifës së shkollimit për të gjithë kategoritë e studentëve të cilët përfitonin rimbursimin e tarifës së shkollimit sipas akteve nënligjore të sipërpërmendura. Me vendim nr. 13, datë 19.02.2019 u miratura që fondi prej 88,900,000 lekësh, nga buxheti i vitit 2019, të përdoret për rimbursimin e menjëhershëm të të gjithë studentëve (për të dyja ciklet e studimit) të cilët përfitojnë rimbursim tarifës së shkollimit sipas VKM-ve të miratuara në paktin për universitetin.

Gjithashtu duhet theksuar se gjatë detajimit të përdorimit të të ardhurave për vitin 2019 Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit kanë marrë në konsideratë edhe likuidimin e detyrimeve të prapambetura në zërin “Investime”.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

Nga të ardhurat e vitit 2019 do të përdoren 83,734,170 lekë (ose 38.7% e të ardhurave të veta të UAMD-së) për të likuiduar shpenzime për investime (për detyrime të trashëguara dhe investime të reja të vitit 2019)

Me vendim nr. 13 datë 19.02.2019 të Bordit të Administrimit u miratua një rialokim në vlerën 88,900,000 lekë, në grantin e vitit 2019” si më poshtë vijon:

- pakësohet në vlerën 88,900,000 lekë fondi i miratuar për shpenzime për paga, për vitin 2019 (art. 600. Kap.8) dhe
- shtohet në vlerën prej 88,900,000 lekësh fondi për “Shpenzime për bursa dhe rimbursim taria shkollimi”. (art. 606, kap. 8), për vitin 2019.

Me shkresën nr. 324, datë 20.02.2019 dërgohet pranë MFE Vendimi nr. 13, datë 19.02.2019.

Qëllimi i rialokimit të këtij fondi ishte përballimi i kostove financiare që do të kishte Institucioni në zbatim të akteve nënligjore të miratuara në kuadër të paketës së akteve të paktit për Universitetin. Ky fond u përdor për rimbursimin e tarifave të shkollimit në masën 100 % për studentët të cilët vijnë nga kategoritë në nevojë dhe rimbursimin në masën 50% të tarifës së shkollimit për studentët të cilët kishin kryer pagesën e tarifës së shkollimit para daljes së akteve nënligjore të paktit për universitetin.

Në zbatim të akteve të sipërcituara MASR disburson fonde shtesë për UAMD për përballimin e kostove financiare për mbështetjen studentore.

Me shkresën nr. 3496 prot., datë 27.03.2019 të, Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës iu akordua granti shtesë për vitin 2019, në vlerën prej 189,888,224 lekësh për zbutjen e impaktit që kishin aktet nënligjore të “Paktit për Universitetin” në buxhetin e Institucionit.

Granti shtesë në vlerën 189,888,224 lekë u detajua me vendim nr. 19 datë 09.04.2019 të Bordit të Administrimit si më poshtë vijon:

- 132,668,000 lekë për shpenzime për paga
- 30,000,000 lekë për shpenzime operative
- 27,220,224 lekë për shpenzime për bursa

UAMD me shkresën nr. 628, datë 09.04.2020 i përcjell MFE Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 19, datë 09.04.2019.

Pas përfundimit të rimbursimit të tarifave të shkollimit për vitin akademik 2018- 2019, Bordi i Administrimit me vendim nr. 41 datë 19.07.2019 miraton një rialokim i fondit prej

10,000,000 lekësh, në grantin e vitit 2019” si më poshtë:

- pakësohet, në vlerën 10,000,000 lekë fondi i miratuar, për mbështetjen studentore, për vitin 2019 (art. 606 kap.8)
- shtohet në vlerën 10,000,000 lekë fondi i miratuar për shpenzime për paga, për vitin 2019 (art. 600. Kap.8)

Me shkresën nr. 1318, datë 22.07.2019 u dërgua pranë MFE Vendimi nr. 41, datë 19.07.2019.

Me shkresën nr. 8186/1, datë 17.09.2019 të MASR, “Për ndryshim në planin e vitit 2019”, për Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, u akordua nga MASR grant shtesë në vlerën prej 13,000,000 lekësh.

Bordi i Administrimit me vendim nr. 55 datë 26.09.2019 miraton detajimin e grantit prej 13,000,000 lekësh si më poshtë :

- 13,000,000 lekë shpenzime për paga.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

Me shkresën nr. 1550 datë 27.09.2019 u dërgua pranë MFE Vendimi nr. 55, datë 26.09.2019.

Me vendim nr. 56 datë 27.09.2019 të Bordit të Administrimit u miratua riallokimi në vlerën 5,000,000 lekë, në grantin e vitit 2019” si më poshtë:

- Pakësohet në vlerën 5,000,000 lekë fondi i miratuar, për mbështetjen studentore, për vitin 2019
- Shtohet në vlerën 5,000,000 lekë fondi i miratuar për shpenzime për paga, për vitin 2019.

Me shkresën nr. 1550/1, datë 27.09.2019 dërgohet pranë MFE Vendimi nr. 56, datë 26.09.2019 i Bordit të Administrimit.

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës ka mbështetur punën kërkimore shkencore nëpërmjet hartimit të projekteve të ndryshme. UAMD aplikon pranë AKKSHI-it me disa projekte dhe dy prej tyre shpallur fitues.

Pas shpalljes nga AKKSHI të dy projekteve fitues të paraqitur nga UAMD, Bordi i Administrimit me vendim nr. 57 datë 26.09.2019 miraton bashkëfinancimin në këto projekte nga të ardhurat e Institucionit, vlerën 10,642,550 lekë, në kuadër të mbështetjes së kërkimit shkencor. Për realizimin e këtyre për dy projekte kërkimore fitues, nga AKKSHI u akordua fondi në vlerën 14,955,090 lekë, për politikën zhvillimit për projektet konkurruese për zhvillimin e institucioneve publike të arsimit të lartë, për vitin 2019, për ndërtimin e dy laboratoreve të rinj.

Gjithashtu në përgjigje të shkresës nr. 635, datë 11.04.2019 të UAMD me objekt “Kërkesë për rimbursim Tvsh-je” nga MASR u akordua fondi prej 3,643,140 lekësh për pagesë TVSH-je për blerje pajisje për projekte me financim të huaj.

Me shkresën nr. 9891/1, datë 12.11.2019 të MASR, për Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, u miratua granti shtesë në vlerën prej 24,650,000 lekë.

Bordi i Administrimit me vendim nr. 66 datë 17.12.2019 miratoi detajimin e grantit shtesë si më poshtë :

- 22,650,000 lekë shpenzime për paga
- 2,000,000 lekë shpenzime operative

Me shkresën nr. 2021/1, datë 17.12.2019 dërgohet pranë MFE Vendimi nr. 66, datë 17.12.2019.

Bazuar në sa më sipër duke marrë në konsideratë grantin e miratuar më 09.01.2019 si dhe të gjitha shtesat, riallokimet e bëra gjatë vitit 2019 buxhetor vjetor/granti i rishikuar për Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, për vitin 2019 paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Në lekë

Art	Analiza	Grup Tit.Kap.			Totali	Ne % ndaj totalit
		Granti mesimdhënies	Grante per TVSH	Grant per kerkimin shkencor		
600	Shpenzime per paga	517,374,759			517,374,759	64%
601	Shpenzime per sigurime shoqerore	80,000,000			80,000,000	10%
602	Shpenzime operative	53,000,000			53,000,000	6.60%
606	Shpenzime per transferta ne individe	135,874,813			135,874,813	17%
231	Shpenzime per investime	-	3,643,140	11,311,950	14,955,090	2.40%
TOTALI		786,249,572	3,643,140	11,311,950	801,204,662	100%

Burimi: UAMD, përpunuar nga grupi i auditimit



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

Realizimi i treguesve për vitin 2019 paraqitet si më poshtë vijon:

Në lekë

Emërtimi	Artikull / Nen artikulli		Buxheti		Grante per TVSH	Fonde nga të ardhura		TOTALI
		Emërtimi	Shpenzime per funksionimin te financuara nga granti	Shpenzime nga buxheti per kerkimin shkencor	Shpenzime per projekte te huaja te financuara nga buxheti	Shpenzime per kerkimin shkencor te financuara nga te ardhurat	Shpenzime per funksionimin te financuara nga te ardhurat	
Shpenzime per projekte	230	Plan	-	-	-	-	8,930	8,930
		Fakt	-	-	-	-	-	-
Shpenzime per investime	231	Plan	-	11,311,950	3,643,140	3,451,200	54,449,689	72,855,979
		Fakt	-	11,311,950	3,643,140	3,451,200	48,338,778	66,745,068
Shpenzime per paga	600	Plan	517,374,759	-	-	-	68,904,126	586,278,885
		Fakt	514,503,240	-	-	-	63,692,882	578,196,122
Shpenzime per sigurime shoqerore	601	Plan	80,000,000	-	-	-	8,630,226	88,630,226
		Fakt	79,946,000	-	-	-	5,734,454	85,680,454
Shpenzime operative	602	Plan	53,000,000	-	-	1,904,287	43,617,306	98,521,593
		Fakt	52,880,333	-	-	1,900,003	39,771,840	94,552,176
Shpenzime per bursa dhe rimbursime	606	Plan	135,874,813	-	-	-	1,887,000	137,761,813
		Fakt	133,385,360	-	-	-	887,000	134,272,360
TOTALI VJETOR 01.01.2019 - 31.12.2019		Plan	786,249,572	11,311,950	3,643,140	5,355,487	177,497,276	984,057,425
		Fakt	780,714,933	11,311,950	3,643,140	5,351,203	158,424,954	959,446,180

Burimi: UAMD, përpunuar nga grupi i auditimit

Sa më sipër rezulton se :

- Shpenzimet për personelin (paga + sigurime) zënë 69% të shpenzimeve totale (të financuara në masën 89.5 % nga granti dhe 10.5 % nga të ardhurat e vet UAMD-së)
- Shpenzimet operative në programin 09450 janë zënë 9.6% të totalit të shpenzimeve dhe janë financiar ne masen 57 % nga granti dhe 43% nga te ardhurat e vet Institucionit
- Shpenzimet operative në programin 09770 (kërkimi shkencor), përfaqësojnë shpenzime për bashkëfinancim në projekte INTERREG. Këto shpenzime janë financiar në masën 100% nga të ardhurat e vet Institucionit.
- Shpenzimet për mbështetjen studentore zënë 14% te totalit të shpenzimeve vjetore.
- Shpenzimet për investime zënë 7 % te totalit të shpenzimeve vjetore.

Sa më sipër aktiviteti financiar i institucionit për vitin 2019 rezulton të jetë financiar në masën 83% nga buxheti dhe 17 % nga të ardhurat e veta.

“Shpenzime për rritjen e aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara” (Art 230 dhe 231) zënë, rreth 6.7% të totalit të shpenzimeve dhe detajimi i tyre paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Në lekë

Objekti i shpenzimit	Burimi i Financimit		Totali
	Buxheti	Të ardhurat e veta	
Shpenzime per punime ndertimore dhe orendi per kontrata te lidhura ne 2013-2017 (detyrime të prapambetura nga kontrata te vitit 2013 - 2017)	0	23,007,034	23,007,034
Shpenzime per realizimin e projekteve te rikonstruksione te rrjetit hidraulik, ngrohje – ftohje, ndricues dhe rikonstruksion ambientesh per vitin akademik 2018 - 2019		23,704,544	23,704,544
Blerje orendi		1,627,200	1,627,200



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

Shpenzime për financimin e blerjes së pajisjeve në kuadër të projekteve kërkimore shkencore	14,955,090	3,451,200	18,406,290
TOTALI	14,955,090	51,789,978	66,745,068

Burimi: UAMD, përpunuar nga grupi i auditimit

Nga këto vlera e investimeve të financuara nga të ardhurat e Institucionit paraqitet në vlerën 51,789,978 lekë, përfshirë këtu edhe 3,451,200 lekë investime për realizimin e projekteve kërkimore. Shpenzimet për investime janë përqendruar kryesisht në likuidimin e detyrimeve të prapambetura nga kontrata të lidhura në vitin 2017 si dhe financimin e punimeve ndërtimore emergjente për rikonstrukcion të rrjeteve hidraulik, ndricues, sistemit ngrohës-ftohës etj.

Të ardhurat e institucionit për vitin 2019 paraqiten si më poshtë:

Në lekë

Përshkrimi	Totali i Arkëtuar
Tarifa Shkollimi	141,955,679
Tarifa për Regjistrimin	5,912,650
Të Ardhura të tjera dytësore	7,974,361
Sponsorizime	5,006,240
Totali	160,848,930

Burimi: UAMD, përpunuar nga grupi i auditimit

Sic shihet edhe nga tabela pjesa më e madhe e të ardhurave (ose 89 % e të ardhurave totale) arkëtohet nga tarifat e shkollimit. Në zërin sponsorizime janë pasqyruar të ardhurat nga kompanitë sponsorizuese të FASTIP-it.

Në vitin 2019 janë arkëtuar 143,095,136 leke më pak të ardhura sesa viti 2018. Kjo ulje spjegohet me faktin se për vitin akademik 2018 – 2019 u përgjysmua tarifa e shkollimit për të gjithë studentët e ciklit të parë të studimit, u rrit numri i kategorisë së studenteve të cilët paguajnë tarife 0 (zero) lekë si dhe numri i studenteve të ciklit të dytë të cilët paguajnë tarifë shkollimi në masën 50%.

Plani i të ardhurave për vitin 2019 paraqitet në vlerën 216,421,319 lekë (të ardhura të trashëguara + të ardhura të arketuara gjatë vitit 2019).

Për vitin 2019 nga të ardhurat janë përdorur:

- ✓ 51,789,978 lekë ose rreth 26.2 % e të ardhurave totale janë përdorur për financimin e investimeve nga të cilat:
 - ✓ 3,451,200 lekë janë investime për financimin e projekteve kërkimore
 - ✓ 24,634,234 lekë janë përdorur për financimin/likuidimin e detyrimeve të prapambetura (kontrata të lidhura në vitin 2016, 2017) ku përfshihet financimi i punimeve ndërtimore për godinën e dytë si dhe pajisja me orënditë dhe pajisjet e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor në këtë godinë.
 - ✓ 23,704,544 lekë janë përdorur për financimin e kontratave të lidhura në vitin 2018.

Gjatë vitit 2019 janë financuar vetëm investime në lidhje me likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe nuk ka financime për angazhime të reja kontratuale.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

- ✓ 69,427,336 lekë ose 35 % e të ardhurave janë përdorur për financimin e shpenzimeve për personelin (paga dhe sigurime). Këtu përfshihen shpenzimet për një muaj të vitit 2019 për personelin me kohë të plotë, shpenzime për orë mësimore suplementare dhe si dhe shpenzime për personel akademik me kohë të pjesshme.
- ✓ 41,671,843 lekë ose rreth 21% e të ardhurave është përdorur për financimin shpenzimeve operative nga të cilat:
 - 1,900,003 lekë janë shpenzime operative për projektet kërkimore,
 - 39,771,840 lekë janë për financimin e shpenzimeve për funksionimin normal të Institucionit ku përfshihen kancelari, detergjent, ujë, energji elektrike, mirëmbajtje periodike, pagesa për komisione, publikime shencore, blerje materiale për organizmin e aktiviteteve, licensim, regjistrim progremesh studimi etj.
- ✓ 887,000 lekë ose 0.5 % e të ardhurave është përdorur për mbështetjen ndaj studentëve.

VITI 2020 /9-mujori

Projekt Buxhetit Afatmesëm 2020 – 2022 është hartuar në mbështetje dhe në zbatim të:

- Udhëzimit nr. 8, datë 28.02.2019 “Mbi përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022”, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë;
- Udhëzimit “Për hartimin e buxhetit të institucioneve të sistemit të arsimit për periudhën afatmesme 2020-2022”, të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave;
- Shkresës nr.7193 prot, datë 17.07.2018 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm për periudhën 2020-2022”, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- Propozimeve të përcjella nga Fakulteti i Biznesit, Fakulteti i Edukimit, Fakulteti i Studimeve Profesionale, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, Fakulteti i Studimeve të Integruara me Praktiken të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm, për periudhën 2020-2022;
- Vendimit nr. 50, datë 14.08.2019 të Senatit Akademik “Për miratimin e PBA 2020-2022 sipas propozimeve të paraqitura nga fakultetet”;
- Vendimit nr. 52, datë 22.08.2019 të Bordit të Administrimit:

Hartimi i Shpenzimeve Funksionale të PBA vitet 2020 -2022

Totali i shpenzimeve të paraqitura në Projekt Buxhetin Afatmesëm (2020 – 2022), për vitin 2020, për Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, paraqitet me një vlerë prej 1,445,622,000 lekë, nga të cilat 1,070,317,000 lekë (ose 74 %) të financuara nga buxheti i shtetit dhe 375,305,000 lekë (ose 26%) të financuara nga të ardhurat e veta;

Kërkesa e paraqitur për vitin 2020 është paraqitur në dy programe, programi 09450 (shpenzime për funksionimin) dhe programi 09970 “shpenzime për kerkimin shkencor”;

Kërkesa totale në programin 09450 është në vlerën prej 1,327,974,000 lekë dhe kërkesa në programin 09770 është në vlerën prej 117,648,000 lekë;

- Kërkesa e paraqitur në këtë projekt buxhet për shpenzime për funksionimin për vitin 2020 paraqitet 73,395,000 lekë më e rritur sesa shpenzimet e pritshme të vitit 2019;



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

- Kërkesa e rritur pasqyrohet në;
- Rritjen e shpenzimeve për personelin në vlerën 44,303,000 më shumë sesa shpenzimet e pritshme të vitit 2019;
- Rritjen e shpenzimeve operative në vlerën 26,704,000 lekë më shumë sesa i pritshmi për vitin buxhetor 2019
- Rritjen e shpenzimeve për bursa në vlerën 2,388,000 lekë.

Mbi zbatimin e buxhetit vjetor 2020

Transferta e pakushtëzuar (Granti i mësimdhënies) i akorduar nga MASR, për Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, për vitin 2020 është në vlerën totale 778,220,045 lekë (715,007,245 lekë granti i mësimdhënies dhe 63,212,800 granti i mbështetjes).

Senati Akademik me vendim nr.1 datë 09.01.2020 ka miratuar draftin mbi detajimin e Grantit të vitit 2020 dhe ia ka përcjell për miratim Bordit të Administrimit.

Bordi i Administrimit me Vendim nr.1, datë 09.01.2019 ka miratuar detajimin e grantit 2019 si më poshtë:

- Për shpenzime për paga është planifikuar 595,007,245 lekë ose 76.5 % e grantit.
- Për shpenzime për sigurime shoqërore është planifikuar 90,000,000 lekë ose 11.5 % e grantit.
- Për shpenzime operative të cilat janë shpenzime për funksionimin e Institucionit ku përfshihen energji, ujë, shërbimi postar, pagesa për akreditim, regjistrim dhe liçensim programesh, pagesa për anëtarë të bodit, senatit akademik dhe komisione) është planifikuar 30,000,000 lekë ose 3.8 % e grantit.
- Shpenzime për shpërndarjen e bursave (fondi i mbështetjes studentore) janë miratuar 63,212,800 lekë ose 8 % e grantit.

Pjesa më e madhe e grantit ose 87 % etij është planifikuar për shpenzime personeli.

Sa i përket shpenzimeve operative të planifikuara për tu financuar nga buxheti, paraqiten në vlerën 30,000,000lekë. Ky fond është planifikuar të përdoret për likuidimin e shpenzimeve të domosdoshme për funksionimin si: furnizimi me energji elektrike për tre godinat, furnizimi me ujë, shërbimin postar dhe pagesa për regjistrim, akreditimin programesh, pagesa e anëtarëve të senatit, bordit dhe komisioneve të tjera, pagesa për kuota anëtarësimi.

Në lidhje me fondin e planifikuar për shpenzime për bursa (fondi i mbështetjes studentore), është planifikuar në vlerën 63,212,800 lekë sipas fondit të miratuar dhe përcjellë nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Me këtë fond është parashikuar të trajtohen me bursë rreth 700 studentë të ciklit të parë.

Me shkresën nr. 36 dt 09.01.2020 UAMD i përcjell MFE vendimin nr. 1 datë 09.01.2020 të Bordit të Administrimit.

Me shkresën nr. 253/1 datë 14.01.2020 MFE dërgon detajimin e grantit të vitit 2020 për UAMD.

Me shkresën nr. 253/2 datë 17.01.2020 MFE i dërgon UAMD-së limitet mujore për vitin 2020.

Me shkresën nr. 11118/4 datë 27.01.2020 MASR i dërgon UAMD-së miratimin e datajimit të grantit të vitit 2020.

Senati Akademik me Vendim nr.2 datë 17.01.2020 miraton dhe i ka përcjell për miratim Bordit të Administrimit.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

Senati akademik me vendim nr. 3 datë 17.01.2020 miraton detajimin dhe përdorimin e të ardhurave për vitin 2020 dhe e ka percjell për miratim Bordit të Administrimit.

Senati akademik me vendim nr. 4 datë 17.01.2020 miraton regjistrin e parashikimit të prokurimit publik të vitit 2020 dhe ia ka percjell për miratim Bordit të Administrimit.

Bordi i Administrimit me Vendim nr. 4 dt 23.01.2020 miraton detajim dhe përdorimin e të ardhurave për vitin 2020 sipas tabelës së mëposhtme.

Në lekë

NR.	EMERTIMI	TE ARDHURA TE PRITSHME PER TU PERDORUR GJATE VITIT 2020 (NE LEKE)	PERDORIMI NE % NDAJ TOTALIT TE TE ARDHURAVE TE PRITSHME PER TU PERDORUR
I	TE ARDHURA TE TRASHEGUARA NGA VITI 2019	17.813.360	
II	TE ARDHURA TE PRITSHME PER T’U ARKETUAR GJATE VITIT 2020	190.435.700	
I+II	TOTALI	208.249.060	
	PERDORIMI	202.520.844	100%
A	Te ardhura te cilat do te perdoren per shpenzime per personelin e ftuar ne FASTIP	10.000.000	4,9%
B	Te ardhura te cilat do te perdoren per te financuar shpenzimet per te paguar detyrimet per sigurime shoqerore dhe shendetsore per stafin me kohe te pjesshme, te pagueshme nga punedhenesi (Art. 601)		
C	TE ARDHURAT TE CILAT DO TE PERDOREN PER TE FINANCUAR SHPENZIMET OPERATIVE (art. 602)	97,400,844	48,1%
c.1	Te ardhurat te cilat do te perdoren per te financuar shpenzime per roje civile (Shpenzime te cilat nuk jane objekt I RPP 2020)	22,000,000	
c.2	Shpenzime per Rrjetin Telematik Shqiptar (RASH)	2,668,320	
c.3	Te ardhurat te cilat do te perdoren per te financuar shpenzime operative per likuidimin e detyrimeve te prapambetura	10,000,000	
c.4	Te ardhurat te cilat do te perdoren per te financuar blerje te cilat jane objekt I RPP 2020 dhe do te financohen sipas realizimit te RPP 2020	55,732,524	
c.5	Te ardhurat te cilat do te perdoren per te financuar shpenzime operative ne kuader te realizimit te projekteve te kerkimit shkencor	5,000,000	
c.6	Te ardhurat te cilat do te perdoren per te financuar botime shkencore me faktor impakti ne revista shkencore jashte vendit	2,000,000	
D	TE ARDHURAT TE CILAT DO TE PERDOREN PER TE RIMBURSUAR STUDENTET (ART.606)	1,000,000	0,5%
E	TE ARDHURAT TE CILAT DO TE PERDOREN PER TE FINACUAR SHPENZIMET PER INVESTIME TE PATRUPEZUARA (art. 230)	800	0,4%
F	TE ARDHURAT TE CILAT DO TE PERDOREN PER TE FINACUAR SHPENZIMET PER INVESTIME TE TRUPEZUARA (art. 231)	93,320,000	46,1%
f.1	TE ARDHURAT te cilat do te perdoren per te likujduar shpenzime per investime per detyrime te trasheguara ne zerin investime	65,000,000	
f.2	TE ARDHURAT te cilat do te perdoren per te likujduar shpenzime per investime te	28,320,000	

Sa evidentohet edhe nga detajimi i mësipërm Universiteti A.Moisiu Durrës ka parashikuar likuidimin e detyrimeve të prapambetura gjatë vitit 2020.

Është miratuar fondi prej 10,000,000 lekesh në (art 602), kap 6 dhe fondi prej 65,000,000 lekesh në (art 231) kap.6 nga të ardhurat e vet Institucionit për likuidimin e detyrimeve të prapambetura. Pra 75,000,000 lekë ose 36% e planit të ardhurave të vitit 2020 është miratuar për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

Bordi i Administrimit me Vendim nr. 5 datë 23.01.2020 ka miratuar regjistrin e parashikimit të prokurimit publik të vitit 2020.

Bordi i Administrimit me Vendim nr. 9 datë 23.01.2020 ka miratuar buxhetin e vitit 2020 (grant + të ardhura)

Me shkresën nr. 111,dt 27.08.2020 të MFE me objekt “Miratim limiti”, është miratuar limiti mujor për rialokimin e fondit, prej 5,000,000 leke.

Në zbatim të ligjit 80/2015 dhe VKM nr 75 datë 12.02.2018 UAMD trashëgon në vitin 2020 grantin e papërdorur të vitit 2019. Bordi i Administrimit me Vendim nr. 16 datë, 14.02.2020



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

miraton financimin nga transfertat e pakushtëzuar e vitit 2020, të shpenzimeve operative, për kontrata të vitit 2020.

Me shkresën nr 3386/1 date 20.02.2020 MASR miraton detajimin e grantit të trashëguar si me poshtë:

2,871,521 lekë trashëgohet në zërin shpenzime për paga viti 2020

54,000 lekë trashëgohet në zërin shpenzime për sigurime shoqërore për vitin 2020

119,667 lekë trashëgohet në zërin shpenzime operative për vitin 2020

2,489,455 lekë trashëgohet në zërin shpenzime për bursa dhe mbështetje financiare për studentët viti 2020.

Bordi i Administrimit me vendim nr. 50 datë 20.05.2020 ka miratuar rialokimin e fondit prej 15,000,000 lekësh si më poshtë:

Pakësohet fondi i pagave për vitin 2020 në vlerën 15,000,000 lekë.

Shtohet fondi për shpenzime operative për vitin 2020 në vlerën 15,000,000 lekë.

Me shkresën nr.637 prot, datë 27.05.2020 UAMD i përcjell MFE Vendimin nr. 50 datë 27.05.2020 të Bordit të Administrimit.

Me shkresën nr. 11841/1 prot, datë 29.06.2020 të MFE me objekt “transferim fondi për shpenzime kapitale” është bërë miratimi i fondit shtesë në vlerën 50,000,000 lekë në zërin shpenzime për investime me objekt “Ndërtimi i Godinës nr.2”

Bordi i Administrimit me vendim nr. 70 prot, datë 07.08.2020 miraton rialokimin e fondit prej 5,000,000 lekësh si më poshtë:

➤ Pakësohet fondi i pagave për vitin 2020 në vlerën 5,000,000 lekë

➤ Shtohet fondi për shpenzime operative për vitin 2020 në vlerën 5,000,000 lekë

Me shkresën nr.980 prot, datë 12.08.2020, UAMD i dërgon MFE Vendimin nr. 70 datë, 07.08.2020 të Bordit të Administrimit.

Me shkresën nr. 15186/1 prot, datë 24.08.2020 dhe me shkresën nr. 15186/2 prot, datë 27.08.2020 MFE i përcjell UAMD-së miratimin e rialokimit për grantin e vitit 2020 si dhe limitet mujore.

Me shkresën nr. 15186/2, dt 27.08.2020 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me objekt “Miratim limiti”, është miratuar limiti mujor për rialokimin e fondit, prej 5,000,000 lekë.

Në lekë

Art.	Lloji i shpenzimit	Financimi nga granti	Financimi nga te ardhurat		Totali
		Gr.11, Prog 09450, kap 8	Gr.11, Prog 09450, kap 6 (shpenzime për funksionimin)	Gr.11, Prog 09770, kap 6 (shpenzime për kerkimin shkencor)	
600	Shpenzime për paga	577,751,408	10,000,000		587,751,408
601	Shpenzime për sigurime shoqërore	90,054,000	-		90,054,000
602	Shpenzime operative	50,119,667	90,400,844	7,000,000	147,520,511
606	Shpenzime për bursa dhe transfertat të tjera për studente	65,829,613	1,000,000		66,829,613



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

230	Shpenzime per investime (te patrupezuara)		800		800
231	Shpenzime per investime (te trupezuara)		86,989,070	6,330,930	93,320,000
TOTALI		783,754,688	188,390,714	13,330,930	985,476,332

Burimi: UAMD, përpunuar nga grupi i auditimit

Si paraqitet edhe në tabelën më sipër në detajimin e buxhetit 2020 granti i miratuar nga MASR do të përdoret për financimin e shpenzimeve prioritare të Institucionit (paga dhe sigurime shoqërore) dhe më pas renditen shpenzimet për mbështetjen studentore.

Realizimi i shpenzimeve faktike për periudhën 01 janar – 30 shtator 2020 paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Në lekë

Art	N/Art.Emertimi	Buxheti	Granti	Buxheti	Jashte limiti	Totali
		11-0.9450-1	11-0.9450-8	11-0.9770-6	11-0.9450-6	
600	PLAN	-	577,751,408	-	5,211,244	582,962,652
	FAKTI	-	411,794,536	-	4,244,269	416,038,805
601	PLAN	-	90,054,000	-	2,895,772	92,949,772
	FAKTI	-	65,683,783	-	1,665	65,685,448
602	PLAN	-	50,119,667	396,522	27,157,729	77,673,918
	FAKTI	-	50,117,065	392,238	26,572,710	77,082,013
606	PLAN	-	65,829,613	-	3,290,000	69,119,613
	FAKTI	-	62,821,858	-	3,166,000	65,987,858
230	PLAN	-	-	-	221,260	221,260
	FAKTI	-	-	-	221,260	221,260
231	PLAN	111,055,120	-	3,378,330	59,249,046	173,682,496
	FAKTI	111,055,120	-	3,378,330	58,638,135	173,071,585
	PLAN	111,055,120	783,754,688	3,774,852	98,025,051	996,609,711
Totali	FAKTI	111,055,120	590,417,242	3,770,568	92,844,039	798,086,969

Burimi: UAMD, përpunuar nga grupi i auditimit

Sa më sipër rezulton se :

- Shpenzimet për personelin (paga + sigurime) janë kryer në vlerën 481,724,253 lekë ose rreth 60% e shpenzimeve totale (të financuara në masën 99 % nga granti dhe 1 % nga të ardhurat e vet UAMD-së)
- Shpenzimet operative në programin 09450 jane kryer në vlerën 77,082,013 lekë ose rreth 10% te totalit të shpenzimeve dhe janë financuar në masen 65 % nga granti dhe 35% nga të ardhurat e vet Institucionit.
- Shpenzimet operative në programin 09770 (kerkimi shkencor) janë kryer në vlerën 392,238 lekë dhe përfaqësojnë shpenzime për bashkëfinancim në projekte INTERREG. Këto shpenzime janë financuar në masën 100 % nga të ardhurat e vet Institucionit.
- Shpenzimet për mbështetjen studentore janë në vlerën 65,987,858 leke ose 8.3% të totalit të shpenzimeve vjetore.
- Shpenzimet për investime janë 173,071,585 lekë ose rreth 22 % të totalit të shpenzimeve vjetore. Shpenzimet për investime janë financuar në masën 64 % nga buxheti dhe 36 %



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

nga të ardhurat. Financimi nga buxheti i përket likuidimit të detyrimeve të prapambetura për punimet ndërtimore për Godinën nr. 2. Më datë 30.09.2020 detyrimi për këtë kontratë është 0 (zero) lekë.

Në lekë

Lloji i të ardhurës	Vlera e arkëtuar
Tarifa Shkollimi	82,891,096
Tarifa Regjistrimi	2,215,000
Të Ardhura të tjera dytësore	3,830,938
Sponsorizime	5,511,601
Totali	94,448,635

Burimi: UAMD, përpunuar nga grupi i auditimit

Gjatë kësaj periudhe nuk është financuar angazhim/kontratë e lidhur rishtazi për investime të reja.

Realizimi i të ardhurave për 9 mujorin 2020 paraqitet më i ulët krahasuar me vitet paraardhëse. Kjo shpjegohet me faktin se tarifat e shkollimit janë ulur por ndërkohë është rritur numri i studentëve të cilët trajtohen me tarifë 0 (zero)lekë apo tarifë të reduktuar në masën 50% për të dyja ciklet e studimit.

Mbi aktet ligjore në fuqi që rregullojnë veprimtarinë financiare

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, në zbatim të nenit 132 të ligjit ka hartuar dhe miratuar aktet rregullativë për përshtatjen e tyre me ndryshimet e ligjit të ri nr. 80/2015.

Statuti i ri i institucionit është miratuar nga ministri përgjegjës për arsimin me Urdhrin nr. 385 datë 09.07.2018, ndërsa Rregullorja e Brendshme e institucionit është miratuar prej Senatit Akademik me vendimin nr. 154 datë 26.11.2018.

Institucioni ende nuk disponon rregulloren financiare të tij e cila miratohet nga Bordi i Administrimit referuar Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, **neni 49** “Funksionet e Bordit të Administrimit në institucionet e arsimit të lartë” **pika 1/e** e tij, ku përcaktohet se:

1. Bordi i Administrimit ka këto funksione kryesore;

e) jep mendim për projektregulloren e institucionit dhe miraton rregulloren financiare të tij;

Kërkesa për hartimin e rregullave lidhur me veprimtarinë financiare të institucionit prashikohen edhe në **nenin 109** “Burimet e financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë”, **pika 2** e tij, ku përcaktohet se:

2. Të ardhurat e përfituara nga shërbimet, veprimtaritë kërkimore-shkencore, konsulencat, si dhe çdo e ardhur që realizohet nga veprimtaria ku merr pjesë personeli akademik ndahet ndërmjet personelit akademik dhe IAL-së, sipas rregulloreve të miratuara nga Bordi i Administrimit.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

nenin 132 të ligjit, si edhe në nenin 93 pika d) të Rregullores së Brendshme të institucionit, çka evidenton nevojën për hartimin e rregullave procedurale që duhet të ndërmerren nga njësitë në UAMD për hartimin dhe zbatimin e buxhetit vjetor.

Institucioni nuk rezulton të ketë miratuar ende Rregulloren mbi Funksionimin e Bordit në kundërshtim me nenin 33 pika 3, neni 132 të ligjit nr. 80/2015 si dhe nenin 93 pika 2/c dhe pika 4 e Rregullores së Brendshme. Mungesa e akteve të rregullative për veprimtarinë krijon risk në garantimin e përmbushjen e misionit, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të institucionit të arsimit të lartë.

Titulli i Gjetjes nr. 1:	Evidentohet mungesa në rregulloret e brendshme të institucionit, mbi funksionimin e Bordit të Administrimit dhe asaj financiare.
Situata:	Nga auditimi rezultoi se, Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, në zbatim të nenit 132 të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë” ka hartuar disa nga aktet rregullativë bazë sipas kërkesave të këtij ligji. Konkretisht është hartuar statuti i ri i cili është miratuar nga ministri përgjegjës për arsimin me Urdhrin nr. 385 datë 09.07.2018, i ndryshuar, si dhe “Rregullorja e Brendshme” e institucionit e miratuar me vendimin nr. 154 datë 26.11.2018 prej Senatit Akademik. Veç akteve bazë të sipërcituar, UAMD nuk ka miratuar ende “Rregulloren mbi funksionimin e Bordit të Administrimit” i cili është organi më i lartë drejtues administrativ në IAL. Po kështu mungon edhe Rregullorja Financiare e cila miratohet prej Bordit të Administrimit.
Kriteri:	-Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 33 pika 3, neni 49 pika 1/a,c,e; nenin 109 pika 2 si dhe neni 132 i tij. -Rregullore e Brendshme e UAMD neni 93 pika 2/c, 2/d, dhe pika 4 e tij. -Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 4 i tij; -Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 5, neni 8 pika 8/ë e tij;
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e këtyre akteve rregullative krijon risk për veprimtarinë në garantimin e mirëfunksionimit administrativ dhe financiar të institucionit të arsimit të lartë.
Shkaku:	Mosplotësim në kohë i kuadrit rregullator.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	UAMD të ndërmarrë veprimet e nevojshme administrative, për hartimin dhe miratimin e “Rregullores për Funksionimin e Bordit të Administrimit”, “Rregullores Financiare” si dhe akteve të tjerë të nevojshëm për plotësimin e kuadrit rregullator të institucionit dhe garantimin e mirëfunksionimit administrativ dhe financiar.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

Drejtimit nr. 3 “Mbi krijimin dhe shlyerjen e detyrimeve”;

Lidhur me këtë drejtim auditimi të tij u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Akt-rakordimi me degën e Thesarit për “Të Ardhurat dhe Shpenzimet” në fund të periudhave vitet 2013 deri 2020/09;
- Treguesit e detyrimeve të palikujduara për investime në fund të periudhave vitet 2013 deri 2020/09;
- Treguesit e paraqitur në Pasqyrat Financiare vjetore vitet 2017-2019, zëri Detyrime/ “Furnitorë e llogari të lidhura me to llog. 401-408”;
- Raporti Përfundimtar i Auditimit të KLSH^{së} miratuar me vendimin e Kryetarit nr.180 datë 30.11.2018 me objekt “Auditim Financiar” për periudhën 01.01.2017 deri më 31.08.2018.
- Të tjera dokumentacione:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Nga auditimi mbi detyrimet e prapambetura gjendje në periudhën 31 dhjetor 2013 nga Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës.

VITI AKADEMIK	VITI USHTRIMOR	Numri i Studentëve me kohë të plotë				Doktoraturë	Gjithsej studentë me Kohë të Plotë	Gjithsej me Kohë të Pjesshme	Numër studentësh në TOTAL	Të ardhura të Veta nga Tarifat për Studim etj.
		BA	2-vjeçare	MSH	MP					
2012 - 2013	2013	8,431		1,126	1,133	86	10,776	2,772	13,548	393,699,003
2013-2014	2014	10,548		1,667	1,444	98	13,757	3,230	16,987	298,463,666
2014-2015	2015	11,269		2,076	1,579	61	14,985	2,933	17,918	328,058,295
2015-2016	2016	11,139		1,973	1,533	50	14,695	2,552	17,247	290,958,152
2016-2017	2017	11,581		1,929	1,882	19	15,411	2,180	17,591	305,466,462
2017-2018	2018	12,359		1,983	2,298	15	16,655	1,698	18,353	303,944,067
2018-2019	2019	11,022	2,068	1,779	2,074	8	16,951	1,571	18,522	160,848,930
2019-2020/09	2020	10,928	2,210	1,940	2,026	8	17,112	1,473	18,585	94,448,635

Burimi: UAMD, përpunuar nga Grupi i Auditimit


Sipas treguesve të paraqitur nga institucioni për periudhën vitet 2013 deri më 2020/09 rezultoi se, megjithëse numri i studentëve ka ruajtur të njëjtin trend rritës, të ardhurat kanë trend të theksuar zbritës në periudhat viti 2019 dhe në vijim. Ecuria e të ardhurave të krijuara nga vet institucioni sipas periudhave paraqitet si më poshtë vijon:



KONTROLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

Ecuria e të Ardhurave të veta në UAMD periudha 2013 -2020/09



Ndërkim në uljen e të ardhurave të veta të krijuara nga institucioni janë vendimet e Këshillit të Ministrave për arsimin e lartë të publikuara në muajin dhjetor 2018, për bursat financiare të studentëve, atyre për përjashtim, apo reduktim të tarifavës vjetore të cilat kanë patur impakt të rëndësishëm në të ardhurat vet institucionit. Po kështu ndikim në të ardhurat pas vitit 2018 ka patur edhe heqja e pagesave shtesë për studentët për tërheqjen e vërtetimeve apo dokumentacioneve të tjera nga Sekretariatë Mësimore, sipas vendimit nr. 163 datë 14.12.2018 të Senatit Akademik në UAMD.

Sa i përket investimeve të bëra përgjatë kësaj periudhe evidentojmë se, vlerat e investimeve të kryera paraqiten në vlera të konsiderueshme për periudhën 2017 dhe 2018 ndërsa për periudhën 2019 dhe 9-mujorin 2020 vlerat kanë pësuar ulje të theksuar çka përkon dhe me trendin e të ardhurave.

Në lekë


Nr.	Periudha	Investime të kryera
1	2014	180,721,373
2	2015	251,456,227
3	2016	251,456,227
4	2017	213,483,337
5	2018	282,719,915
6	2019	75,000,543
7	2020-9M	15,126,460

-Grafikisht situata paraqitet si më poshtë vijon:



KONTROLI I LARTË I SHETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës



- Vlerat e papaguara drejt furnitorëve të mallrave dhe shërbimeve për periudhën nën auditim 2013-2020/09 referuar treguesve financiarë të institucionit të paraqitur edhe në Pasqyrat Financiare vjetore vitet 2013-2019 si dhe të dhënat e kontabilitetit të njësisë parqiten si më poshtë vijon:

Tabela nr.1 “Ecuria e vlerave financiare të palikujduara sipas periudhave”

Nr.	Periudha	Vlera e papaguar në fund të periudhës	Llog. 404 "Furnitorë për investime"	Llog. 401 "Furnitorë"
1	2013	223,858,269	223,816,769	41,500
2	2014	133,318,646	133,318,646	0
3	2015	78,831,245	78,831,245	0
4	2016	28,827,682	28,827,682	0
5	2017	115,986,473	110,539,614	5,446,859
6	2018	240,826,452	239,481,096	1,345,356
7	2019	234,889,733	227,838,693	7,051,040
8	2020-9M	73,381,326	69,672,126	3,709,200

Burimi: UAMD, përpunuar nga Grupi i Auditimit


Sa vërehet në tabelën më sipër, vlerat e palikujduara i referohet në masën gati 100% të tyre investimeve të kryera në UAMD dhe në një masë shumë të vogël i përkasin mallrave apo shërbimeve të prokuruar. Trendi i ecurisë së vlerave të papaguara paraqitet grafikisht më poshtë vijon.



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës


Vlerat e papaguara 2013- 9M/2020



Sa më sipër në periudhën 2013-2016 shuma e llogarive 401 “Furnitorë” dhe 404 “Furnitorë për investime” paraqiten në ulje duke arritur vlerën më të ulët të tyre, kjo në përputhje edhe me strategjinë ‘Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit miratuar me VKM nr. 50, datë 5.2.2014, i ndryshuar i cili në ka në fokus jo vetëm shlyerjen detyrimeve të mbartura por gjithashtu parandalimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura në të ardhmen.

Ndërkohë që në vitin 2017 -2018 ecuria paraqitet me rritje të tyre duke kapur vlerën më të lartë të tyre për periudhën nën auditim. Në fund të vitit 2019 kemi një ulje të lehtë të detyrimeve ndërkohë më tej, më datë 30.09.2020 situata paraqitet e përmirësuar me rreth 70% krahasuar me çeljen e vitit buxhetor.

Ecuria e detyrimeve për vlera investimesh të palikujduara ka të njëjtin trend njëlloj me atë të detyrimeve gjithsej duke qenë se zënë gati 100% të tyre, grafikisht këto detyrime paraqitet si më poshtë vijon:



Vlera e papaguar për investime të kryera në UAMD më datë 30.09.2020 paraqitet në vlerën 69,672,126 lekë dhe përbëhet nga zërat si më poshtë:

-Mobilim ambientesh Korpusit 22,936,480 lekë



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

-Punime sistemimi ambientesh të jashtme	16,169,077 lekë
-Blerje kompjuterësh	14,028,000 lekë
-Instalim sistem kondicionimi	9,330,035 lekë
-Të tjera	5,208,534 lekë

Nga vlerat e mësipërme, 14,905,200 lekë i përkasin furnizimeve të kryera gjatë vitit 2020 ndërsa 54,766,926 lekë i përkasin faturave të palikujduara nga periudha të mëparshme, për të cilat institucioni duhet të marrë masat për likuidim të tyre përpara kryerjes së investimeve të reja.

Titulli i Gjetjes nr. 1:	Evidentohen detyrime të prapambetura mbi investime të kryera nga UAMD.
Situata:	Nga auditimi rezultoi se, Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, në fund të muajit shtator 2020 paraqitet me një situatë detyrimesh të palikujduara në shumën rreth 73.4 milion nga të cilat 69.7 milion lekë përfaqësohen nga “Detyrime për investime” ndërsa pjesa tjetër i përket detyrimeve për mallra dhe shërbime. Nga vlera e papaguar për investime, rreth 54.8 milion lekë ose rreth 79% janë detyrime të mbartuara nga periudha të mëparshme, ndërsa 14.9 milion lekë ose rreth 21% e tyre i përkasin detyrimeve të krijuara në 9 mujorin e vitit 2020. Investimet e palikuiduara u përkasin punimeve ndërtimore dhe pajisje të nevojshme për godinën e re universitare. Në fund të vitit 2018 si rrjedhojë e aplikimit të reduktimit të tarifave studentore si dhe heqjes së pagesave shtesë për studentët për tërheqjen e dokumentacioneve të tjera nga Sekretaritet Mësimor, të ardhurat e institucionit janë tkurrur ndjeshëm. Këto ndryshime kanë përgjysmuar të ardhurat, ndërkohë që institucioni trashëgonte vlera të konsiderueshme detyrimesh të prapambetura nga periudhat e mëparshme. Megjithatë planifikimet buxhetore në periudhat vijuese kanë qenë konservatore, ende sot një pjesë e këtyre detyrimeve të trashëguara qëndrojnë në regjistrat e institucionit si detyrime për tu paguar. Pavarësisht nevojës për investime dhe ambiente të reja, në funksion të mësimdhënies dhe cilësisë së saj, nga ana e institucionit duhej të ishte ndjekur një qasje më e kujdesshme mbi planifikimin dhe kryerjen e tyre në kohë, me qëllim ruajtjen e balancave financiare dhe mosakumulimin e vazhdueshëm të tyre. Moslikuidimi i detyrimeve sipas afateve të përcaktuara në kontratë e ekspozon buxhetin e institucionit drejt risqeve për pagesa kamatëvonesash shtesë.
Kriteri:	- VKM nr. 50, datë 05.02.2014 “Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit”, të ndryshuar”, -Udhëzimi nr. 5 datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, i ndryshuar: Ligji nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”-Të tjera akte ligjore, nënligjore e rregullative.
Ndikimi/Efekti:	Krijim detyrimesh të prapambetura të cilat krijojnë risk për penalitete nga klauzolat e kontratës.
Shkaku:	Moslikuidim në kohë i detyrimeve
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	UAMD të kryej një planifikim më të kujdesshëm të investimeve të reja duke i dhënë prioritet fillimisht likuidimit të detyrimeve të prapambetura dhe respektuar rigorozisht radhën FIFO për pagesë referuar momentit kur detyrimi ka lindur.

IV- GJETJET DHE REKOMANDIMET



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si *më poshtë*:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, në zbatim të nenit 132 të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë” ka hartuar vetëm disa prej akteve rregullativë të kërkuar nga ligji. Konkretisht është hartuar statuti i ri i cili është miratuar nga ministri përgjegjës për arsimin me Urdhrin nr. 385 datë 09.07.2018, i ndryshuar, si dhe “Rregullorja e Brendshme” e institucionit e miratuar me vendimin nr. 154 datë 26.11.2018 prej Senatit Akademik. Veç akteve të sipërcituar, UAMD nuk ka hartuar dhe miratuar ende “Rregulloren mbi funksionimin e Bordit të Administrimit” i cili është organi më i lartë drejtues administrativ në IAL si dhe “Rregulloren Financiare” e cila miratohet prej Bordit të Administrimit. Referuar kërkesave të ligjit kjo bazë rregullative duhet të hartohet brenda vitit të parë akademik nga hyrja në fuqi e ligjit. Mospërbushja e këtij detyrimi nga ana e institucionit bie në kundërshtim me neni 33 pika 3, neni 49 pika 1/a,c,e, dhe neni 132 të ligjit nr. 80/2015 por dhe akteve ligjore e nënligjor mbi hartimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit. Ndikimi evidentohet si në aspektin e mirëfunksionimit organizativ por dhe atij financiar, pasi këto akte rregullativë përmbajnë proceset dhe hapat që duhet të ndërmerren nga njësitë e veçanta në IAL, për hartimin e buxhetit vjetor dhe atij afatmesëm si dhe rolin mbikëqyrës të Bordit të Administrimit në zbatimin e tij. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 19-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

1.1 Rekomandimi: UAMD të ndërmarrë veprimet e nevojshme administrative, për hartimin dhe miratimin e “Rregullore për Funksionimin e Bordit të Administrimit”, “Rregullore Financiare” si dhe akteve të tjerë të nevojshëm për plotësimin e kuadrit rregullator të institucionit dhe garantimin e mirëfunksionimit administrativ dhe financiar.

Menjëherë

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se, Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, në fund të muajit shtator 2020 paraqitet me një situatë detyrimesh të palikujduara në shumën rreth 73.4 milion nga të cilat 69.7 milion lekë përfaqësohen nga “Detyrime për investime” ndërsa pjesa tjetër i përket detyrimeve për mallra dhe shërbime. Nga vlera e papaguar për investime, rreth 54.8 milion lekë ose rreth 79% janë detyrime të mbartuara nga periudha të mëparshme, ndërsa 14.9 milion lekë ose rreth 21% e tyre i përkasin detyrimeve të krijuara në 9 mujorin e vitit 2020. Investimet e palikuiduara u përkasin punimeve ndërtimore dhe pajisje të nevojshme për godinën e re universitare. Në fund të vitit 2018 si rrjedhojë e aplikimit të reduktimit të tarifave studentore si dhe heqjes së pagesave shtesë për studentët për tërheqjen e dokumentacioneve të tjera nga Sekretaritet Mësimorë, të ardhurat e institucionit janë tkurrur ndjeshëm. Këto ndryshime kanë përgjysmuar të ardhurat, ndërkohë që institucioni trashëgonte vlera të konsiderueshme detyrimesh të prapambetura nga periudhat e mëparshme. Megjithatë planifikimet buxhetore në periudhat vijuese kanë qenë konservatore, ende sot një pjesë e këtyre detyrimeve të trashëguara qëndrojnë në regjistrat e institucionit si detyrime për tu paguar. Pavarësisht nevojës për investime



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport Përfundimtar për auditimin e ushtruar në “Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës

dhe ambiente të reja, në funksion të mësimdhënies dhe cilësisë së saj, nga ana e institucionit duhej të ishte ndjekur një qasje më e kujdesshme mbi planifikimin dhe kryerjen e tyre në kohë, me qëllim ruajtjen e balancave financiare dhe mosakumulimin e vazhdueshëm të tyre. Moslikuidimi i detyrimeve sipas afateve të përcaktuara në kontratë e ekspozon buxhetin e institucionit drejt risqeve për pagesa kamatëvonesash shtesë, referuar përcaktimeve të nenit 5 të ligjit nr.48/2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”. *Trajtuar më hollësisht në faqet nr 50- 55 Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

1.1 Rekomandimi: UAMD të kryej një planifikim më të kujdesshëm të investimeve të reja duke i dhënë prioritet fillimisht likuidimit të detyrimeve të prapambetura dhe respektuar rigorozisht radhën FIFO për pagesë, referuar momentit kur detyrimi ka lindur.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenet 52 dhe 67, të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutin dhe Rregulloren e Brendshme të Institucionit, si dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi, **i rekomandohet** Administratorit të Institucionit, të analizoj dhe vlerësoj, të metat dhe mangësitë e trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit sipas përgjegjësisë individuale dhe të nisë menjëherë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse.

D. SHËNIM I KRYETARIT

Duke qenë se, auditimi është tematik dhe i fokusuar në trajtimin e ankesës së administruar në KLSH me nr. 723 prot, datë 24.07.2020, drejtimet e auditimit që kanë të bëjnë me hartimin dhe zbatimin e buxhetit, si dhe ecurinë e detyrimeve të prapambetura, janë trajtuar në funksion të ankesës së sipërcituar, ndërsa mbulimi i plotë me auditim i këtyre drejtimeve, do të jetë objekt i auditimit të rradhës që do të zhvillohet pranë këtij institucioni.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT